

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5634
E mërkurë, 21 nëntor 2018
çmimi 0.40

**Integrimi i gjyqtarëve
dhe prokurorëve serbë
në veri vlerësohet
jotransparent** I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHEREMET AHMETI I FAQE 4-5

Mosanëtarësimi në Interpol s'duhet ta demotivojë Kosovën

Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Sheremet Ahmeti, e ka quajtur dëshpërues mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol. Ai ka thënë se lobimi i mbrapshtë i Serbisë dhe aleatëve të saj ka pamundësuar që Kosova të bëhet anëtare e kësaj

organizate. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka deklaruar se shtetet anëtare është dashur të insistojnë që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit dhe jo të votojnë kundër. Sidoqoftë, ai ka thënë se kjo disfatë nuk duhet ta demotivojë

Kosovën. Përkundrazi, Ahmeti ka theksuar se Policia e Kosovës duhet të jetë stabile, e fuqishme dhe të vazhdojë ta luftojë krimin. Ai ka thënë se asnjëherë Kosova nuk duhet të heqë dorë nga nevoja e të qenit anëtare e Interpolit



AKTUALE

**FEHMIU DHE XHEVA I KANË
TEJKAHUAR TË GJITHA
FIGURAT E MËDHA TË
LUFTËTARËVE TË ÇLIRIMIT
TË ATDHEUT** F. 12

Ismet
SYLEJMANI



**'HASAN PRISHTINA'
RENDITET I 713-ti NË
DATABAZËN SCIMAGO** F. 7

**BYTYQI: DO TË ANGAZHOHEMI
QË FËMIJËVE TANË T'U
SIGUROJMË TË ARDHME MË
TË SIGURT** F. 6

EKONOMI

**BE-ja NDAN 2.5 MILIONË
EURO PËR MTI-NË QË T'I
RRISË INVESTIMET E HUAJA
DIREKTE** F. 9

SPORT

**Feston
Kosova** F. 9



**Ministri
Shala
e quan të
paligjshëm
ngritjen e
çmimit të
bukës** I FAQE 8



Dështon anëtarësimi i Kosovës në Interpol



Kosova ka dështuar, në përpjekjen e saj, që të bëhet anëtare e Interpolit, pasi as në raundin e dytë të votimit nuk ka mundur t'i marrë 2/3 e votave të vendeve pjesëmarrëse në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj organizate e cila po mbahet në Dubai.

Institucionet e Kosovës për këtë dështim e kanë fajësuar Serbinë se u ka bërë presion vendeve anëtare të Interpolit për ta kundërshtuar kërkesën e Kosovës, por partitë opozitare për dështimin në Interpol e kanë fajësuar pushtetin I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bashkimi Evropian mbështet Kosovën në rrugën evropiane

Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, në takim me veçantë me kryeparlamentarin Kadri Veseli, theksoi përkushtimin e Bashkimit Evropian për ta mbështetur Kosovën në rrugën evropiane, forcimin e kapaciteteve të brendshme dhe për ta lehtësuar dialogun me fqinjët



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli gjatë qëndrimit të tij për vizitë zyrtare në Bruksel, Veseli, të martën në orët e pasdites është pritur në një takim të veçantë nga përfaqësuesja e lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Federica Mogherini. Veseli dhe Mogherini gjatë këtij takimi kanë biseduar për gjendjen e përgjithshme në Kosovë, rrugën e integriteteve evropiane, me theks të veçantë zbatimin e MSA-së dhe procesin e liberalizimit të vizave.

Kreu i Kuvendit të Kosovës tha se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për liberalizim të vizave dhe tani, pas rekomandimit pozitiv të Komisionit Evropian dhe votimit në Parlamentin Evropian, pret vendimmarrje pozitive brenda këtij viti nga ana e Këshillit të Ministrave të BE-së. Ai vlerësoi se anëtarësimi i Kosovës në BE është objektiv nacional i Kosovës dhe përbën konsensusin politik të të gjithë spektrit politik në

Kosovë.

Në këtë takim, kryetari i Kuvendit konfirmoi qëndrimin institucional të Kosovës për t'i zgjidhur me dialog çështjet e hapura me të gjithë fqinjët e saj, në mënyrë të veçantë me Serbinë, ndërsa shfaqti bindjen se dialogu midis dy shteteve do të përmbyllet me njohjen reciproke të tyre.

Shefja e diplomacisë evropiane, Mogherini, theksoi përkushtimin e Bashkimit Evropian për ta mbështetur Kosovën në rrugën evropiane, për forcimin e kapaciteteve të brendshme dhe për ta lehtësuar dialogun me fqinjët.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka takuar edhe kryetaren e Senatit të Belgjikës, Christine Defraigne, me të cilën ka diskutuar për zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe për thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve.

Kryeparlamentari Veseli e njoftoi homologen belge me angazhimet e institucioneve të Kosovës dhe për reformat e ndër-

marra në rrugën e integritetit euroatlantik, për reformat në drejtësi, administratë publike, veçmas për përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave. Megjithatë, Veseli theksoi nevojën e përkrahjes së shteteve mike, në këtë rast të Belgjikës, për t'i dhënë këtij procesi epilog pozitiv dhe të shumëpritur nga qytetarët e Kosovës brenda këtij viti. "Mbretëria e Belgjikës e mbështet Kosovën në të gjitha

proceset integruese dhe në procesin e liberalizimit të vizave.

Në takim me kryetaren e Senatit e njoftova atë se Kosova po vazhdon rrugën drejt integriteteve evropiane dhe në rrafshin e brendshëm po bën reformat e nevojshme për zhvillim ekonomik", theksoi Veseli.

Kryesentorja belge, Christine Defraigne, i dha mbështetje të plotë kryeparlamentarit Veseli dhe institucioneve të Kosovës për angazhimin dhe punën e tyre për

përmbushjen e reformave të nevojshme në rrugën e integritetit evropian dhe për zhvillim më të madh ekonomik. Ajo konfirmoi mbështetjen e shtetit të saj për Kosovën në të gjitha proceset që lidhen me të ardhmen euroatlantike dhe të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të saj. Të dy homologët u pajtuan se bashkëpunimi i shkëlqyer midis Kosovës dhe Belgjikës mund të avancohet më tej, sidomos në rrafshin ekonomik.

Nikolla Gruevski fiton azil në Hungari, Shkupi kërkon ekstradim



SHKUP, 20 NËNTOR - Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, përmes një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se autoritetet hungareze kanë pranuar kërkesën e tij për azil politik në këtë vend. "Sot, Republika e Hungarisë, si vend anëtar i BE-së dhe NATO-s, i është përgjigjur pozitivisht kërkesës sime të parashtruar më parë me kërkesën për status politik për shkak të ndjekjes

politike në Republikën e Maqedonisë. Në kërkesën për azil politik kanë theksuar se të njëjtën e kërkoj për shkak të ndjekjes politike nga Qeveria e re e udhëhequr nga partia LSDM. Unë nuk kam ikur nga drejtësia, por duke shfrytëzuar metoda të tjera demokratike ndërkombëtare vazhdoj ta kërkoj drejtësinë për mua dhe të gjitha viktimat e tjera të ndjekjes politike në Maqedoni",

ka shkruar Gruevski, duke e akuzuar Qeverinë për, siç ka thënë, kaos, politizim të gjyqësorit, rrënim të shtetit juridik, rrezikim të interesave kombëtare dhe shtetërore.

Njoftimi i Gruevskit vjen vetëm disa çaste pasi Ministria e Drejtësisë e Maqedonisë ua ka dërguar autoriteteve të Hungarisë kërkesën për ekstradim të ish-kryeministrit Nikolla Gruevski.

Ambasada e ShBA-së: Presim zbatim të ligjit për ish-ministrin Tahiri

TIRANË, 20 NËNTOR - Ambasada e ShBA-së në Tiranë përmes një postimi në rrjetet sociale ka vlerësuar arritjet e deritanishme në drejtësi, si dënimi i Emiljano Shullazit, por thekson se pret përparim të vazhdueshëm në rrugën e Shqipërisë drejt sundimit të fortë të ligjit, e që ai të zbatohet edhe gjatë hetimit

në vazhdim për Saimir Tahirin. "Gjykata e Krimeve të Rënda të Shqipërisë dënoi Emiljano Shullazin dhe grupin e tij, por presim përparim të vazhdueshëm në rrugën e Shqipërisë drejt sundimit të fortë të ligjit. Dje Gjykata e Apelit të Tiranës dëgjoi argumentet e prokurorëve lidhur me masën e

sigurisë për Ervis Martinaj. Ne presim hetimin e plotë të tij, ashtu siç presim që sundimi i ligjit të zbatohet gjatë hetimit në vazhdim për Saimir Tahirin. Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për të ardhmen e Shqipërisë", thuhet në statusin e Ambasadës së ShBA-së në Tiranë.



Republika e Kosovës nuk ka arritur të anëtarësohet në Interpol

Dështon anëtarësimi i Kosovës në Interpol

Kosova ka dështuar, në përpjekjen e saj, që të bëhet anëtare e Interpolit, pasi as në raundin e dytë të votimit nuk ka mundur t'i marrë 2/3 e votave të vendeve pjesëmarrëse në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj organizate e cila po mbahet në Dubai. Institucionet e Kosovës për këtë dështim e kanë fajësuar Serbinë se u ka bërë presion vendeve anëtare të Interpolit për ta kundërshtuar kërkesën e Kosovës, por partitë opozitare për dështimin në Interpol e kanë fajësuar pushtetin



SHBA-të: Me mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol, të gjithë humbasim

Përmes një deklarate për medie edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovës ka reaguar ndaj mospranimit të Kosovës në Interpol. Sipas Ambasadës së ShBA-së, me këtë veprim humbasin të gjithë. "Policia e Kosovës është institucion i integruar plotësisht dhe i aftë, që ka dëshmuar qartazi se ka ndihmuar në shpërbërjen e rrjeteve ndërkombëtare terroriste, të krimeve kibernetike, narkotikëve, armëve dhe të trafikimit të qenieve njerëzore. Shumica e vendeve e kanë parë këtë gjë dhe e kanë mbështetur

kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Interpol, përkundër fushatës, të udhëhequr nga Serbia, për t'u bërë presion vendeve për ta kundërshtuar kërkesën e Kosovës. Mbështetja për anëtarësimin e Kosovës në Interpol kurrë nuk ka qenë për pranimin e pavarësisë së Kosovës, por për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit dhe për të mbyllur një boshllëk kritik të sigurisë në Ballkan. Me këtë rezultat, të gjithë humbasim", është thënë në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Republikës së Kosovës falënderon të gjitha shtetet që votuan për, si dhe të gjithë ata që u përpoqën ta ndihmojnë Kosovën në këtë proces të rëndësishëm", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendëskryeministër, Fatmir Limaj, ka thënë se mospranimi i Kosovës në Interpol është lajm i keq për ata që duan më shumë siguri, paqe e stabilitet dhe për gjithë ata që kanë nevojë për partneritet në luftimin e krimit dhe rrjeteve terroriste. "Shpallja e fitores së Serbisë për mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol shpërfaq edhe një herë qartë se

udhëheqja shtetërore serbe as nuk ka qenë dhe as nuk është për paqe, stabilitet, normalizim dhe bashkëpunim në rajon", është thënë në reagimin e Limajt.

Opozita fajëson pushtetin për dështimin në Interpol

Subjektet opozitare e kanë fajësuar presidentin dhe Qeverinë për dështimin e Kosovës në Interpol. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", se me udhëheqjen aktuale të Kosovës nuk mund të priten rezultate të tjera. "Pas dështimit për anëtarësim në

UNESCO, Kosova dështoi për t'u anëtarësuar edhe në Interpol. Me këta njerëz të njëjtë që na përfaqësojnë dhe prijnë me shtetin nuk mund të kemi rezultate të tjera. Në këtë dështim kishte gjithçka përveç rastësisë. As nuk dinë dhe as nuk duan të përgatiten. Nuk shkojnë jashtë vendit si zyrtarë të përgjegjshëm të shtetit tonë, por si personalitete të shoubizit ndërkombëtar siç e imagjinojnë veten", ka shkruar Kurti.

Kurse shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se mosanëtarësimi në Interpol është zhgënjim për Kosovën dhe dështim për sigurinë në Ballkan. "Nuk do të ndalemi derisa të jemi pjesë e Interpolit dhe të gjitha organizatave ndërkombëtare. Ky është zhgënjim për Kosovën, por edhe dështim për sigurinë në Ballkan. Faj të madh ka edhe diplomacia agresive e Serbisë e rreshtuar kundër vlerave që ngrehën mbi gjeopolitikat euroatlantike në rajon. Të nxjerrim mësim nga ky refuzim sot. Duhet të vazhdojmë të jemi unikë në atë që aspirojmë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe Partia Socialdemokrate ka shprehur zhgënjimin e saj për mosmbështetjen e mjaftueshme për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. "Fushata agresive e Qeverisë së Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol dëshmon dështimin e dialogut të deritanishëm midis Kosovës dhe Serbisë. Ngjarja e sotme duhet të shërbejë si leksion për pushtetin, që të bashkërendohet me opozitën, për ta rikonfiguruar sa më parë dialogun me Serbinë. Dialogu i drejtuar nga presidenti Thaçi po e bën Serbinë çdo ditë e më shumë agresive kundrejt Kosovës", është thënë në deklaratën për medie të PSD-së

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Republika e Kosovës nuk ka arritur të bëhet anëtare e Interpolit pasi nuk ka marrë shumicën e nevojshme prej 2/3 të votave të vendeve pjesëmarrëse në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj organizate. Në rrethin e dytë të votimit, Kosova ka marrë 68 vota për, 51 kundër dhe 16 abstenime, kurse në rrethin e parë të votimit pro Kosovës kishin votuar 76 shtete, kundër 56, kurse 22 shtete kanë abstenuar. Pas votimit, institucionet e Kosovës kanë shprehur zhgënjimin e tyre të thellë, duke e fajësuar Serbinë për këtë dështim. Sipas tyre, me fushatën e saj të egër diplomatike Serbia ka bërë presion te vendet anëtare të Interpolit për ta kundërshtuar kërkesën e Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nga Dubai ka deklaruar se me mospranimin e Kosovës në Interpol ka vetëm humbës. "Kosova e ka rrugëtimin e vet si vend i pavarur dhe sovran, por votimi i sotëm shtrën nevojën e një përkushtimi edhe më të madh të spektrit politik dhe institucional të Kosovës dhe qytetarëve për një unitet të qëndrueshëm dhe funksional", ka thënë Thaçi. "Interpoli është një mekanizëm i rendit dhe ligjit dhe se Kosova ka dëshiruar të jetë pjesë e kontributit të paqes, stabilitetit, të luftës globale kundër korrupsionit, krimit të organizuar, terrorizmit dhe të gjitha dukurive negative. Kjo e drejtë, fatkeqësisht, sot Kosovës iu mohua", është shprehur Thaçi.

Edhe ministri i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili ka qenë në Dubai, ka treguar se është bërë punë mjaft e madhe për anëtarësim e Kosovës në këtë organizatë. "Kemi bërë punë të madhe, por kjo nuk u shpërblye. Është vështirë që në këto kushte të sigurohen dy të tretat e votave të bashkësisë ndërkombëtare.

Nuk duhet të dekurajohemi, duhet të ecim përpara dhe kërkoj unitet nga spektri politik i Kosovës. Një është e sigurt, kësaj iniciative nuk i kanë munguar përkushtimi dhe puna. Nuk kemi lënë gjë pa bërë, asgjë nuk ia kemi lënë rastit, kemi punuar, por në fund e patë se nuk arritëm t'i sigurojmë edhe 12 vota të nevojshme për anëtarësim", ka thënë Pacolli pas votimit. Ai ka thënë se në fushatën e saj Serbia ka qenë e pamëshirshme për ta kundërshtuar Kosovën në këtë rrugëtim. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pranuar se e marta nuk ishte një ditë e mirë për Kosovën. "Sot nuk ishte ditë e mirë për Kosovën por, më i fuqishëm se fakti i mosanëtarësimit në Interpol, është fakti se as Serbia me politikën e vet të pengimit ndërkombëtar të Kosovës, as krimi i organizuar e as terrorizmi nuk do të mund ta ndalin fuqizimin e shtetit të Kosovës dhe integrimin ndërkombëtar të tij. Kosova krenohet me policinë e vet. Është policia më profesionale në rajon dhe më gjerë. Me profesionalizmin e saj të dëshmuar, Policia e Kosovës e ka bërë shtetin tonë partner të besueshëm dhe efektiv në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, në veçanti kundër terrorizmit", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Facebook".

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se mosanëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë i bën shërbim vetëm krimit. "Fushata e egër e Republikës së Serbisë dëshmoi edhe një herë karakterin e saj kundër Kosovës dhe kundër idesë për normalizim të raporteve me Republikën e Kosovës, aq më parë kur ky anëtarësim ishte teknik dhe jo politik. Votimi kundër pranimi të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare i bën shërbim vetëm krimit dhe kriminelëve dhe askush nuk do të duhej t'i gëzohej këtij fakti. Qeveria e

Flet për "Epokën e re", Sheremet Ahmeti

Mosanëtarësimi në Interpol s'



Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Sheremet Ahmeti, e ka quajtur dëshpërues mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol. Ai ka thënë se lobimi i mbrapshtë i Serbisë dhe aleatëve të saj ka pamundësuar që Kosova të bëhet anëtare e kësaj organizate. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka deklaruar se shtetet anëtare është dashur të insistojnë që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit dhe jo të votojnë kundër. Sidoqoftë, ai ka thënë se kjo disfatë nuk duhet ta demotivojë Kosovën. Përkundrazi, Ahmeti ka theksuar se Policia e Kosovës duhet të jetë stabile, e fuqishme dhe të vazhdojë ta luftojë krimin. Ai ka thënë se asnjëherë Kosova nuk duhet të heqë dorë nga nevoja e të qenit anëtare e Interpolit

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Sheremet Ahmeti, ka thënë të martën se institucionet e vendit janë angazhuar mjaft, por lobimi i mbrapshtë i Serbisë dhe aleatëve të saj i pamundësuan Kosovës që të bëhet anëtare e

Interpolit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se mospranimi i Kosovës në këtë organizatë është gabim meqë siguria globale është interes i përgjithshëm. Ahmeti ka deklaruar se shtetet anëtare është dashur të insistojnë që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit dhe jo të votojnë kundër. "Mosanëtarësimi në Interpol na

ka dëshpëruar të gjithëve dhe unë nuk kam pritur një gjë të tillë. Përkundrazi, kam pritur që shtetet anëtare do të insistojnë që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit dhe jo të votojnë kundër", është shprehur ai, duke shtuar se kjo disfatë nuk duhet ta demotivojë Kosovën. Përkundrazi, Ahmeti ka theksuar se Policia e Kosovës duhet të jetë stabile, e fuqishme dhe ta vazhdojë luftimin e krimit. "Policia e Kosovës duhet të dëshmojë edhe më tutje se është partnere e sigurt dhe e besueshme për të koordinuar dhe bashkëpunuar me të gjitha agjencitë policore të vendeve të botës", ka theksuar ai. Sipas Ahmetit, asnjëherë Kosova nuk duhet të heqë dorë nga nevoja e të qenit anëtare e Interpolit. Pavarësisht prej mosanëtarësimit në Interpol, ai është shprehur i bindur se Policia e Kosovës do të angazhohet edhe më fuqishëm për luftimin e krimit. "Jam shumë i sigurt se Policia e Kosovës do ta bëjë punën e vet, pra do ta luftojë në çdo formë krimin dhe Kosova nuk do të mbetet mbrapa në këtë

drejtim. Përkundrazi, do të jetë shembull i një vendi ku luftohet e keqja dhe ku do të ketë rend, qetësi dhe rregull", ka thënë Ahmeti.

"Epoka e re": Z. Ahmeti, si e komentoni mospranimin e Kosovës në Interpol?

Ahmeti: Fatkeqësisht, Kosova nuk arriti të pranohet në Interpol. Nuk kam pritur të ndodhë një gjë e tillë sepse kam besuar se Kosova do të bëhet anëtare e barabartë e vendeve të Interpolit. Por, lobimi i mbrapsht i Serbisë dhe aleatëve të saj ia pamundësuan Kosovës të bëhet anëtare e kësaj organizate. Është gabim i madh dhe nga kjo nuk fiton as Serbia. Fitojnë ata që dëshirojnë ta shohin Kosovën vend ku do të lulëzojë krimi i organizuar. Jam shumë i sigurt se Policia e Kosovës do ta bëjë punën e vet, pra do ta luftojë në çdo formë krimin dhe Kosova nuk do të mbetet mbrapa në këtë drejtim. Përkundrazi, do të jetë shembull i një vendi ku luftohet e keqja dhe ku do të ketë rend, qetësi dhe rregull.

"Epoka e re": Cilat janë arsyet kryesore që Kosova nuk arriti të bëhet pjesë e kësaj organizate të sigurisë?

Ahmeti: Policia e Kosovës ka dhënë dëshmi të mjaftueshme me punën e vet të palodhshme dhe profesionale. Operacionet e shumta të cilat i ka realizuar kanë qenë shumë të suksesshme, prandaj nuk besoj se ka munguar asgjë, mirëpo Serbia me aleatët e vet kanë bërë gjithçka që Kosova mos të pranohet në Interpol. Kosova kurrë nuk do të jetë oazë e kriminelëve, por do të jetë vend i qetë, ku do të ndihen të lirë dhe të sigurt të gjithë qytetarët.

"Epoka e re": Ka pasur lobim të duhur nga diplomacia dhe politika e Kosovës për këtë proces?

Ahmeti: Konsideroj se institucionet e Kosovës kanë bërë çdo gjë që ka qenë e mundshme. Janë angazhuar, kanë lobuar dhe në çdo kohë kanë vrapuar pas nevojës për të qenë anëtare të Interpolit, por edhe përkundër kësaj, Serbia ia ka dalë t'i bindë shtetet e tjera që të votojnë

duhet ta demotivojë Kosovën



dështuar sepse angazhimi i tyre nuk ka munguar. Ato kanë qenë absolutisht pro anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe sigurisht se edhe në të ardhmen do të na mbështesin në të gjitha sfidat dhe nevojat që do t'i ketë Kosova, mbi të gjitha Policia e Kosovës. Policia e Kosovës është dëshmuar me angazhimin, punën dhe profesionalizimin e vet. Të gjitha trajnimet që i ka realizuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit policia ka treguar rezultate të mira. Prandaj mosanëtarësimi në Interpol na ka dëshpëruar të gjithëve dhe unë nuk kam pritur një gjë të tillë. Përkundrazi, kam pritur që shtetet anëtare do të insistojnë që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit dhe jo të votojnë kundër.

"Epoka e re": Pse një numër i konsideruar i shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës kanë votuar kundër pranimit të saj në Interpol?

Ahmeti: Nuk dua ta komentoj këtë çështje. Policia e Kosovës është shumë profesionale dhe besoj se në të ardhmen mund ta kemi mbështetjen edhe të atyre shteteve.

"Epoka e re": Serbia po i frikësohet anëtarësimit të Kosovës në Interpol për shkak se në të ardhmen zyrtarët e saj mund të jenë cak i Interpolit për shkak të veprimtarisë së tyre kriminale?

Ahmeti: Serbia nuk e dëshiron Kosovën të sigurt, të qetë, të prosperuar, por e do një Kosovë me gjendje kaotike dhe me krim dhe, natyrisht, për këtë bën çdo gjë. Por jam i sigurt se Policia e Kosovës do ta vazhdojë punën e vet me këmbëngulje për të ofruar siguri, rend dhe rregull për të gjithë qytetarët në Kosovë dhe më gjerë.

"Epoka e re": Sipas mendimit tuaj, cilët janë hapat që duhet të ndiqen tash e tutje?

Ahmeti: Policia e Kosovës duhet ta vazhdojë punën, angazhimin dhe koordinimin me të gjitha agjencitë policore për realizimin e aksioneve të shumta për t'i ndërprerë veprimet kriminale të çfarëdo forme, mbi të gjitha krimin e organizuar, terrorizmin dhe ekstremizmin.

"Epoka e re": Në vazhdimësi ju e lavdëruat policinë dhe punën e saj. Do të thotë kjo se Policia e Kosovës është mjaftueshëm e përgatitur dhe profesionale për t'u bërë pjesë e organizatës më të madhe të sigurisë, por ka dështuar për shkak të politikës?

Ahmeti: Nuk do të them se ka dështuar për shkak të politikës sepse politika ka bërë punën dhe angazhimin e vet. Mirëpo mundësitë e Kosovës janë këto që

janë. Nuk po e lavdëroj Policinë e Kosovës, por është realitet ajo që po them, sepse deri më tani është dëshmuar profesionalizmi i saj. Edhe sa kam qenë pjesë aktive e saj, edhe tani ndihem mirë dhe jem i bindur se Policia e Kosovës do ta bëjë punën më të mirë të mundshme sepse ajo është në interes të qytetarëve tanë.

"Epoka e re": Nuk duhet të demotivohemi nga humbja e "betejës" së Interpolit?

Ahmeti: Absolutisht nuk duhet të demotivohet as policia e as Kosova. Përkundrazi, Policia e

Kosovës duhet të jetë stabile, e fuqishme dhe duhet ta vazhdojë punën e vet për luftimin e së keqes dhe krimit. Policia e Kosovës duhet të dëshmojë edhe më tutje se është partnere e sigurt dhe e besueshme për të koordinuar dhe bashkëpunuar me të gjitha agjencitë policore të vendeve të botës.

"Epoka e re": Pavarësisht prej kësaj disfate, Kosova duhet t'i vazhdojë përpjekjet për t'u bërë pjesë e Interpolit, qoftë edhe në vitin e ardhshëm, apo duhet pritur normalizimin e marrëdhënieve

me Serbinë?

Ahmeti: Asnjëherë Kosova nuk duhet të heqë dorë nga nevoja e të qenit anëtare e Interpolit. Në këtë aspekt duhet të bëhen punë, përkushtim dhe angazhim. Unë i përgëzoj kolegët e mi për punën e mirë që po bëjnë dhe dështimi në Interpol nuk duhet t'i demotivojë ata, përkundrazi duhet t'i fuqizojë që të jenë të vendosur në punën e tyre sepse Kosovës nuk ia duan të mirën ata që duan ta shohin vendin tonë të zhjytur në krim. Prandaj jam i bindur se Policia e Kosovës do të angazhohet edhe më fuqishëm për luftimin e krimit.

Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në veri vlerësohet jotransparent

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka organizuar panel diskutimi me temën "Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës". Aty u diskutua procesi i arritjes së Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësinë, përmbajtja dhe roli i saj në integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës. Për më tepër, fokus i veçantë iu kushtua zbatimit të kësaj marrëveshje, veprimeve të ndërmarra deri më tani si dhe vështirësitë e paraqitura në procesin integruar. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duke folur për procesin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një rast suksesi, ka vlerësuar se për herë të parë që nga pavarësia Kosova ka arritur ta shtrijë sovranitetin e vet edhe në komunat veriore. Kryetarja e Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës, Albulena Haxhiu, e ka konsideruar këtë proces tërësisht jotransparent dhe jofunksional. Ajo ka thënë se negociimi i shtetit të Kosovës me shtetin e Serbisë lidhur me shuarjen e strukturave kriminale dhe joligjore në veri është goditje për sovranitetin e shtetit të Kosovës. Ndërsa kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Nehat Idrizi, ka thënë se, pavarësisht prej sfidave të tilla, si numri i lëndëve në krahasim me kapacitetet njerëzore, barrierat gjuhësore



dhe mungesa e përkthyesve, ky proces është duke shkuar gradualisht drejt normalizimit dhe integritetit të plotë në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës. Ai ka theksuar se KGJK-ja është duke e hartuar një udhëzues për kriteret dhe procesin e validimit të vendimeve të strukturave paralele gjyqësore si dhe ka pohuar faktin që aktualisht ndarja e lëndëve te gjyqtarët për momentin bëhet në baza gjuhësore. Gjatë këtij paneli u bë prezantimi i analizës së titulluar: "Drejt Jugut: Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës", hartuar nga GLPS-ja. Në këtë analizë janë identifikuar problemet e shkaktuara me Marrëveshjen e Brukselit për Drejtësinë dhe problemet me të cilat përballlet procesi i integritetit të veriut. Si një ndër problemet e identifikuara në analizë është decentralizimi i kompetencës së Gjykatës së Apelit dhe krijimi i një entiteti të veçantë për të, në kundërshtim me ligjin ekzistues. Pastaj,

ndarja e lëndëve në bazë të përkatësisë etnike të palëve dhe në baza gjyqësore kundër parimit esencial ligjor për ndarjen e lëndëve në bazë të parimit të rastësisë. Njëkohësisht, analiza ka gjetur logjikë për krijimin e një procesi të validimit të vendimeve të strukturave paralele gjyqësore deri më tani, mirëpo ky sistem assesi nuk bën të përdoret për rastet lidhur me vendosjen e lëndëve penale, lëndëve të punës dhe të drejtën e pronësisë. Për më tepër, problem kyç është identifikuar të jetë zëvendësimi i stafit profesional dhe rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj si pasojë e shkollimit të tyre në një sistem të ndryshëm arsimor ligjor nga ai i Kosovës. Po ashtu, problemi i mungesës së përkthyesve në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe në degët e saj, në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë dhe në Akademinë e Drejtësisë, është cilësuar të jetë rrjedhojë e mospërgatitjes paraprake të institucioneve shtetërore kosovare për një proces të tillë integruar.

kundër. Vota kundër e këtyre shteteve është gabim sepse siguria kombëtare dhe globale është interes i përgjithshëm dhe Kosova do të kontribuojë që kjo siguri të jetë në nivel të duhur.

"Epoka e re": Pse Serbia ia doli, me aleatët e vet, dhe jo Kosova e cila e kishte mbështetjen e disa shteteve të fuqishme, të Gjermanisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të tjera?

Ahmeti: E keni parë deklaratën për medie të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmes së cilës përkrahet fuqishëm Republika e Kosovës dhe Policia e Kosovës?! Nuk dyshoj fare në atë se miqtë dhe aleatët tanë nuk kanë bërë çdo gjë për t'u anëtarësuar Kosova në Interpol por, për fat të keq, ndodhi kjo që ndodhi.

"Epoka e re": Do të thotë kanë dështuar disa prej shteteve më të fuqishme në botë karshi Serbisë dhe aleatëve të saj?

Ahmeti: Nuk do të them se kanë

Në disa dyqane nuk largohen produktet me etiketim "Kosovë/o dhe Metohi"

MITROVICË, 20 NËNTOR (ER) - Ditë më parë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka marrë vendim t'i ndalojë të gjitha produktet në treg që nuk i referohen Kosovës si shtet. Për këtë rast inspektorët komunalë të Komunës së Mitrovicës kanë dalë të martën në terren për t'i parë nga afër nëse janë larguar të gjitha produktet që mbajnë këtë përmbytje a jo.

Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka theksuar se kanë hasur në disa mallra që importohen në Kosovë me mbishkrimin "Kosovë/o dhe

Metohi", "Kosovë/o UNMIK" apo "Kosovo/a Rezoluta 1244". "Ne sot kemi dalë në terren për të parë nga afër nëse janë larguar produktet të cilat kanë këtë mbishkrim. Kështu kemi vepruar sipas urdhërësës së lëshuar nga ministri Shala, i cili ka urdhëruar që inspektorët të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që menjëherë t'i largojnë nga tregu produktet me etiketim 'Kosovë/o dhe Metohi', 'Kosovë/o UNMIK' apo 'Kosovo/a Rezoluta 1244', apo çdo emërtim tjetër i cili është në kundërshtim me emërtimin zyrtar të Republikës së Kosovës", ka

thënë drejtori Ahmeti.

Po ashtu, drejtori i Inspeksionit ka bërë me dije se duhet të zbatohet neni 15 i Ligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit, i cili obligon inspektorët ta ndalojnë dhe ta sanksionojnë shitjen, shërbimin dhe dhurimin e duhanit dhe pijeve alkoolike personave nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Drejtori Ahmeti ka njoftuar se inspektorët komunalë kanë konstatuar se disa markete që punojnë në Komunën e Mitrovicës tashmë i kanë larguar produktet e këtilla nga hapësirat e tyre.



Bytyqi: Do të angazhohemi që fëmijëve tanë t'u sigurojmë të ardhme më të sigurt

VUSHTRRI, 20 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me shefin Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin dhe kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kanë vizituar Shkollën Fillore "Mustafë Venhari" në Vushtri. Kjo vizitë u realizua në kuadër të aktiviteteve që po zhvillohen kudo në botë dhe në Kosovë, për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, me ç'rast morën pjesë në një orë mësimi kushtuar kësaj ngjarje. Ministri Bytyqi, ndër të tjera, është shprehur se kjo ngjarje është e veçantë për fëmijët tanë dhe të gjithë botës dhe ka theksuar nevojën e angazhimeve të përbashkëta me qëllim që të krijojmë një ambient të lumtur dhe perspektivë të ndritshme për fëmijët. "Sot është një ditë e veçantë për fëmijët e gjithë botës, ndërsa jemi këtu për të shënuar këtë ngjarje së bashku me nxënësit e shkollës fillore në Vushtri, ku për disa çaste edhe diskutuam lidhur me angazhimet që po i bëjmë në



vazhdimësi. Ne do të angazhohemi në vazhdimësi që t'u sigurojmë fëmijëve tanë një të ardhme më të sigurt, një edukim cilësor, t'u sigurojmë një ambi-

ent sa më të mirë, që fëmijët tanë të zhvillohen sikurse fëmijët e Evropës dhe gjithë botës", ka deklaruar ministri Bytyqi. Ndërsa shefi i Zyrës së UNICEF-

it në Kosovë, Murat Sahin, ka thënë se ndihet i lumtur që së bashku me fëmijët e kësaj shkolle po e shënojnë këtë ngjarje të nivelit global. Ai ka shtuar se

UNICEF-i angazhohet çdo ditë e kudo në botë që t'i mbështesë fëmijët në rritjen e tyre, në edukimin sa më cilësor dhe perspektivën e tyre në jetë.

Deputetët Deliu e Zemaj llobojnë për vizat

VJENË, 20 NËNTOR (ER) - Blerta Deliu-Kodra, kryetare e Komisionit për Integritet Evropian dhe Armend Zemaj, zëvendëskryetar, po marrin pjesë në takimin Plenar LX të Konferencës së Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlamenteve të BE-së (COSAC), që po mbahet në Vjenë të Austrisë, nga 18 - 20 nëntor 2018. Ky takim plenar i COSAC-ut është organizuar në kuadër të dimensionit parlamentar nga Presidenca Austriake e Këshillit të Bashkimit Evropian. Temë kryesore e këtij takimi ishin:

gjendja aktuale në të cilën ndodhet Bashkimi Evropian gjatë Presidencës Austriake të Këshillit të BE-së, çështja e Brexitit - gjendja aktuale, politikat rreth klimës dhe Bashkimit Energjetik, si dhe transparenca e Bashkimit Evropian për qytetarët e saj në ditën e zgjedhjeve të ardhshme për Parlamentin Evropian. Gjatë zhvillimit të punimeve të takimit të COSAC-ut, Deliu-Kodra dhe Zemaj janë takuar me përfaqësues të ndryshëm të parlamenteve të shteteve anëtare të BE-së dhe kanë diskutuar lidhur me mbështetjen e tyre ndaj

Kosovës në procesin e integritet evropian dhe rreth procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën. Gjithashtu, deputetët Deliu-Kodra dhe Zemaj kanë kërkuar mbështetjen e këtyre përfaqësuesve të komisioneve parlamentare për çështje të BE-së të shteteve anëtare në çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Po në këto takime është diskutuar rreth perspektivës evropiane të Kosovës dhe për mundësitë e bashkëpunimit kryesisht ndërmjet komisioneve homologe. Në këtë konferencë të COSAC-ut morën pjesë përfaqësuesit e



Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlamenteve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian,

Parlamenti Evropian, shtetet me statusin e vendit kandidat dhe kandidat potencial, vendet e partneritetit lindor etj.

‘Hasan Prishtina’ renditet i 713-ti në databazën Scimago

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema, është shprehur i lumtur për vlerësimin e punës së stafit akademik që, sipas tij, ka rezultuar me renditjen e lartë të UP-së në databazat e njohura, siç është ajo e Scimagos dhe Webometrics

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" është renditur në vendin e 713 në databazën e Scimagos. Në këtë renditje, në të cilën UP-ja është institucioni i vetëm i Kosovës dhe i gjithë hapësirës shqiptare (jo vetëm si universitet, por edhe si institucion), ai renditet në vendin e 713 prej 5 637 institucioneve të përfshira në renditje, ndërkaq zë vendin e 87 nga të gjitha universitetet e renditura të Evropës Lindore. Në garën e institucioneve të arsimit të lartë, në këtë ranglistë, ku prin Universiteti i Harvardit, UP-ja renditet i 563-ti në botë,



duke lënë pas vetes universitete të shumta me renome botërore. Ky është viti i parë në të cilin UP-ja është pjesë e kësaj rangliste prestigjioze botërore. Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema, është shprehur i lumtur për vlerësimin e punës së stafit akademik që, sipas tij, ka rezultuar me renditjen e lartë të UP-së në databazat e njohura, siç është ajo e Scimagos dhe Webometrics.

"Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina', duke u renditur në top 800-shen e institucioneve shkencore në botë, ka dëshmuar edhe një herë që vazhdon të jetë universiteti numër një kudo që flitet shqip", ka deklaruar Dema, i cili për këtë sukses ka uruar organet drejtuese, stafin akademik dhe administrativ, studentët e UP-së, qeveritarët dhe gjithë qytetarët. Ndërkaq për prorektorin për kërkime shkencore në UP, prof. dr. Faton Berisha, ky sukses i

Universitetit të Prishtinës i tejkalon pritjet e tij për arritje shkencore gjatë mandatit të menaxhmentit aktual të UP-së, në krye me profesor Demën, veçanërisht për nga aspekti i kualitetit të kërkimeve shkencore. Rangimin e lartë të UP-së në databazën e Scimagos e përshëndetën edhe zëvendësiministri në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Hestet Sahiti dhe shefi i Programit të Transformimit të Lidershipit -

Bursave dhe Partneriteteve, World Leaning, Carl Hammerdorfer. Ata uruan menaxhmentin e UP-së për suksesin e shënuar. Databaza Scimago metodën e renditjes e ka kryesisht të bazuar në punimet e publikuara dhe të indeksuara në databazën e njohur Scopus. Për këtë, ky sukses i Universitetit të Prishtinës është një ndër sukseset më të mëdha të shkencës në vendin tonë në vitet e fundit.



BERZh-i konfirmon përkrahjen për Kosovën

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim zëvendëspresidentin e parë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) Jurgen Rigtterink, i cili përmes këtij takimi hapi zyrtarisht vizitën në Kosovë. Me këtë rast, ministri Hamza ka theksuar se BERZh-i vazhdon të jetë një ndër partnerët kyç dhe strategjik të Kosovës për realizimin e projekteve të mëdha infrastrukturore. Ai shprehi edhe një herë vullnetin e Ministrisë së Financave për ta intensifikuar

bashkëpunimin aktual me BERZh-in. Gjatë takimit ministri Hamza i dorëzoi zëvendëspresidentit Rigtterink kërkesën për financim të projektit për ndërtimin e Qarkores së Prishtinës, për të cilin pritet që marrëveshja financiare të përmbyllet vitin e ardhshëm. Ndërsa zëvendëspresidenti Jurgen Rigtterink ka shprehur edhe një herë gatishmërinë e BERZh-it për ta mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes realizimit të projekteve prioritare për vendin.

Ministri Ismaili inspekton punimet në Spitalin Pediatrik Kirurgjik

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, së bashku me një delegacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe, kanë vizituar të martën vendpunimin ku po ndërtohet Spitali

Pediatrik Kirurgjik. Gjatë kësaj vizite ministri Ismaili ka thënë se, pas shumë vitesh zvarritje, është kënaqësi të shohësh që punimet kanë nisur me intensitet të lartë dhe objekti më në fund po merr

formën e tij. "Pas shumë vitesh zvarritje, objekti i Spitalit Pediatrik Kirurgjik ngadalë po merr formën e tij. Së bashku me përfaqësuesit e Emirateve të Bashkuara Arabe sot vizituam

punimet të cilat po zhvillohen me intensitet të lartë që brenda 22 muajve të kemi një spital modern që do t'i integrojë të gjitha shërbimet shëndetësore për fëmijë", ka thënë Ismaili.



Projektet për ujëmbledhësit dhe trajtimin e ujërave të zeza, prioritet i Qeverisë



VJEN, 20 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës zyrtare në Austri ka zhvilluar të martën një takim me delegacionin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), i kryesuar nga zëvendësprezidenti i parë i BERZh-it, Jurgen Rigterink. Fillimisht, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar Rigterinkun për të arriturat e Kosovës dhe për përkushtimin e

Qeverisë për fuqizimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, për stabilitetin makrofiskal dhe për angazhimin e institucioneve të Kosovës për fuqizimin e sundimit të rendit dhe të ligjit.

Kryeministri Haradinaj ka falënderuar Rigterinkun dhe BERZh-in për përkrahjen e projekteve zhvillimore të Kosovës në fushat si zhvillimi i sektorit privat, zhvillimi i sektorit të energjisë

dhe zhvillimi i ndërlidhjes infrastrukturore të Kosovës me vendet në region. Më tej, kryeministri Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e mëtutjeshme të BERZh-it në projekte që do ta fuqizonin zhvillimin e zonave industriale për korporatat, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për ta rritur produktivitetin dhe përmirësuar cilësinë, ndërmarrjet eksportuese dhe fusha të tjera të cilat do të

ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies sociale për qytetarët dhe stabilitetin e bizneseve në Kosovë.

Ndërsa zëvendësprezidenti i parë të BERZh-it, Jurgen Rigterink, ka vlerësuar progresin e Kosovës, duke thënë se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën për zhvillimin e projekteve dhe investimeve për të ardhmen. Në

këtë takim të dyja palët u zotuan për implementimin e projekteve infrastrukturore, si rehabilitimi i rrjetit hekurudhor Hani i Elezit - Prishtinë, rruga Kijevë - Zahaq, ndërlidhja e Kosovës me gazsjellësin TAP, implementimi i projekteve për trajtimin e ujërave të zeza derisa në fokus të Qeverisë do të jetë ndërtimi i digave për rritjen e kapacitetit ujqor të Kosovës dhe projekti unaza e jashtme e qytetit të Prishtinës.

Ministri Shala e quan të paligjshëm ngritjen e çmimit të bukës

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, e ka quajtur jo të ligjshëm dhe të panevojshëm ngritjen e çmimit të miellit dhe bukës pas taksës prej 10 përqindësh ndaj importit të produkteve serbe dhe atyre nga Bosnja. Shala gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm, ka thënë se nuk ka arsye për rritje të çmimeve të produkteve



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm, ka thënë se nuk ka arsye për rritje të çmimeve të produkteve. Ai ka shtuar se kjo ngritje është koordinuar nga disa shoqëri tregtare në disa komuna. Sipas Shalës, Kosova tash mbulon 80 përqind të nevojave të saj me grurë. "Në të dhënat që i kemi, Kosova tash mbulon 80 përqind

të nevojave të saj me grurë por, përkundra kësaj, mundësia që ta kontrollojmë këtë ngritje jo të ligjshme apo jo të nevojshme të çmimit të miellit dhe të bukës, kam kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës ta ushtrojë mandatin e vet. S'ka arsye për rritje të çmimit. Kjo rritje e çmimit është e koordinuar nga disa shoqëri tregtare, kryesisht në Prizren dhe Kaçanik", ka thënë Shala.

Ministri Shala ka thënë se ka kërkuar nga inspektorati, në kuadër të MTI-së, të kërkojë nga operatorët ekonomikë largimin e ambalazhit apo të produkteve me mbishkrimin "Kosovë/o dhe Metohi". Shala ka treguar se ka kërkuar edhe nga Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit

dhe Veterinarisë (AUV) që të mos lejojnë hyrjen e asnjë produkti që është në kundërshtim me ligjet e Kosovës. "Kam njoftuar Doganën e Kosovës që në bashkëpunim me AUV të mos lejojnë hyrjen e asnjë produkti me atë mbishkrim. Këtu nuk do të shitet asnjë mall ku shkruhet 'Kosova Metohija' apo 'Prishtina', sepse kam informacione se janë duke shkruar edhe emra të disa qyteteve të tjera dhe

jo emrin që është importues për shtetin e Kosovës", ka deklaruar ministri Shala.

Ndërkaq deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka kërkuar të rritet taksa ndaj produkteve të Serbisë nga 10 në 25 përqind. Ministri Shala ka thënë se është pro këtij propozimi, por që fillimisht do të duhej ta merrte pëlqimin e Qeverisë. "Unë jam i gatshëm ta zbatoj çdo

vendim të Qeverisë. Në këtë drejtim pres edhe përkrahjen e deputetëve për këtë çështje", ka thënë Shala.

Javë më parë Qeveria e Kosovës ka vendosur taksë 10 përqind për prodhimet e importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Përgjatë nga kjo masë bëjnë produktet e brendeve ndërkombëtare të prodhuara në këto dy vende.

BE-ja ndan 2.5 milionë euro për MTI-në që t'i rrisë investimet e huaja direkte

Ministra e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare - IFC kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi për mbështetjen dhe promovimin e Kosovës si destinacion unik për investime

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Korporatën Financiare Ndërkombëtare - IFC, pjesë e Grupit të Bankës Botërore që u përfaqësua nga Thomas Lubeck, drejtor Rajonal për Evropën Juglindore (IFC) dhe Riccardo Serri, drejtor i Seksionit Ekonomik dhe Politik pranë Zyrës së Bashkimit

Evropian në Kosovë.

Ministri Shala ka theksuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e vlerëson lart punën dhe partneritetin e deritashëm me IFC-në, pjesë e Grupit të Bankës Botërore. "Dëshiroj ta konfirmoj edhe një herë interesimin dhe gatishmërinë tonë që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. Me këtë rast e falënderoj edhe Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë si njërin ndër donatorët më aktiv në Kosovë dhe njërin nga partnerët tanë më të rëndë-

sishëm për rrugëtimin e Kosovës në integrimet rajonale dhe evropiane", ka thënë ministri Shala.

Ai ka shtuar se "projekti për hartimin e politikave për promovimin e investimeve në Ballkanin Perëndimor" është një projekt rajonal që mbulon vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ka për qëllim të asistojë Qeverinë e Kosovës në përpjekjet e saj për përmirësimin e infrastrukturës rregullore për përmirësimin e mëtejshëm të klimës së investimeve si dhe harmonizimin e politikave rajonale të investimeve me standardet evropiane, "që do t'i ndihmojë vendet e këtij rajoni, përfshirë edhe Kosovën, të avancojnë më tutje procesin e integritimeve në Bashkimin

Evropian. Gjatë takimeve tona të përditshme me investitorët e huaj dhe vendorë po shohim se po rritet numri i investitorëve të interesuar për të investuar në Kosovë dhe MTI-ja me ndihmën e këtij projekti të ri po synon ta përmirësojë infrastrukturën ligjore dhe rregullore për ta bërë Kosovën vend atraktiv për investitorët e huaj. Po ashtu, synojmë ta përmirësojmë klimën e investimeve për bizneset, t'i harmonizojmë politikat tona të investimeve me standardet evropiane dhe t'u shërbejmë investitorëve në mënyrë më efikase", ka thënë ministri Shala.

Zëvendëshefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Riccardo Serri, ka pohuar se BE-ja është investitorja më e madhe në Kosovë

dhe se ky projekt do të financohet nga BE-ja me 2.5 milionë euro. Në kuadër të këtij projekti do të përfshihen këto aktivitete: Zhvillimi dhe vendosja e një agjende rajonale për reforma lidhur me politikat e promovimit të investimeve të huaja; të bëhet formalizimi/zyrtarizimi i kësaj agjende rajonale për reforma nëpërmjet instrumenteve të duhura zbatuese; të bëhet implementimi dhe monitorimi i reformave lidhur me investimet e huaja në vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) sipas Agjendës Rajonale për Reforma lidhur me investimet e huaja; promovimi i Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) si destinacion unik për investime.



KISA për një vit i ka ofruar ATK-së përvojë në sigurinë kibernetike

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Vitin e kaluar Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Agjencia Shtetërore e Koresë së Jugut për Internet dhe Siguri (KISA) patën nënshkruar një memorandum mirëkuptimi, me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e sigurisë kibernetike. Qëllimi i këtij memorandum është lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve për promovimin e projekteve që nxisin bashkëpunimin në fushat e ndërlidhura me sigurinë kibernetike.

Në kuadër të këtij memorandum ATK-ja ka implementuar një projekt për ngritjen e kapaciteteve teknike si dhe për transformimin e përvojës në sigurinë kibernetike të sistemeve informative. Projekti në fjalë ka përfunduar me sukses, mirëpo ATK-ja dhe KISA kanë shprehur interesim dhe gatishmëri që bashkëpunime të kësaj natyre të ketë edhe në të ardhmen. KISA është edhe një nga shumë institucionet ndërkombëtare me të cilat ATK ka krijuar vija të bashkëpunimit.



Dhurohet makina e analizatorit të gazit në repartin e Neonatologjisë në Gjakovë

Gjakovë, 20 nëntor (ER) - Aksioni për Nënë dhe Fëmijë, bashkë me organizatorët "Çiklizmi rreth Kosovës për fëmijët", dorëzuan makinën e analizatorit të gazit - GEM 3000 për Repartin e Neonatologjisë në Gjakovë - aparat ky esencial për matjen e nivelit të oksigjenit dhe dyoksid karbonit tek ato foshnja që kanë vështirësi me frymëmarrje dhe është thelbësore për diagnostikimin e hershëm nëse foshnja duhet të dërgohet për trajtim të specializuar në kujdes të tretë (terciar). Ky aparat u sigurua nga

fondet e ngritura nga turneu vendor "Çiklizmi rreth Kosovës për fëmijët" e cila është një ngjarje bamirëse vjetore e ciklistëve vendorë për të mbledhur fonde për Fondacionin Humanitar Aksioni për Nënë dhe Fëmijë.



Për nder të Ditës së Flamurit organizohet panairi tradicional 'Blej shqip'

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, do ta organizojë panairin tradicional "Blej shqip" 2018 për

nder të Ditës së Flamurit. Panairi do të mbahet më 27, 28 dhe 29 nëntor në Bulevardin "Nënë Tereza" dhe Sheshin "Zahir Pajaziti", nga ora 10:00 deri në orën 24:00. Pjesëmarrja në panair është

pa pagesë. Ky panair tashmë tradicional vizitohet nga dhjetëra mijëra qytetarë shqiptarë e të huaj dhe ka për synim promovimin e produkteve nga të gjitha trevat shqiptare.

Latifi kërkon që të mbrohet ambienti

RAHOVEC, 20 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të martën një takim, pas vendimit për shqiptim të gjobave ndaj hedhjes së mbeturinave në vendet joadekuate. Në takim ishin të pranishëm komandanti i Stacionit Policor në Rahovec, Osman Ismajli,

pjesëtarët e Policisë së Kosovës, inspektorët komunalë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspeksionit, rojet e pyjeve, kompanitë për mbledhjen e mbeturinave si dhe zyrtarja për mjedis. Gjatë takimit kryetari Latifi ka kërkuar përkushtim maksimal nga të gjitha palët për mbrojtje të

ambientit dhe ka autorizuar inspektorët komunalë që t'i shqiptojnë gjobat mandatore për mjedis. "Qëllimi im nuk është të dënohen qytetarët, por është thjesht një thirrje për ndërgjegjësim, për ta mbrojtur dhe ruajtur ambientin dhe natyrën e bukur që ka Komuna e Rahovecit", ka thënë Latifi.



Syla dhe Papadopoulou diskutuan për bashkëpunimin e ndërsjellë

MITROVICË, 20 NËNTOR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Shyqyri Syla, ka pritur në takim shefen e EULEX-it në Kosovë, Alexandra Papadopoulou, me të cilën ka diskutuar rreth integritetit të prokurorëve dhe stafit të të gjitha komuniteteve në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës si dhe për punët që

po bëhen në këtë prokurori. Syla ka deklaruar se Prokuroria Themelore e Mitrovicës është shembull i integritetit të mirë dhe bashkëpunimit të shkëlqyer në mes të të gjitha komuniteteve që punojnë në këtë institucion. Po ashtu, Syla i ka njoftuar mysafirët për të arriturat në institucionin që e udhëheq ai dhe ka thënë se

është bërë një punë e mirë dhe është i kënaqur me rezultatet e arritura. Të pranishmit u pajtuan që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen në mes të Prokurorit të Shtetit dhe misionit të EULEX-it në Kosovë, si dhe kryeprokurorit Syla iu premtoi përkrahja e këtij misioni për Prokurorinë Themelore të Mitrovicës.

Përrurohet aneksi i Gjinnazit 'Hamdi Berisha' në Malishevë

MALISHEVË, 20 NËNTOR (ER) - Në Komunën e Malishevës është përruruar aneksi i Gjinnazit "Hamdi Berisha". Me këtë aneks, përfundimisht zgjidhet problemi i hapësirës në këtë institucion shkollor. Në ceremoninë e përrurimit të këtij aneksi ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, zëvendësministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport,

Rexhep Mazreku, drejtori i Drejtorisë për Arsime dhe Edukim, Blerim Thaçi dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë komunale. Me këtë rast, Begaj ka thënë se janë të përkushtuar që të krijojnë kushte sa më të mira për nxënësit. "Jemi të përkushtuar që të krijojmë kushte sa më të mira për arsim dhe këtë po e dëshmojmë me punën që jemi duke bërë", ka thënë Begaj.



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /27/

Dënime drakonike për anëtarët e KNDSH-së



**Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA**

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

d) Kanë mbledhur materiale si ndihma per bandatë e armatosuna tue i konsiderue keta si ushtri te veten.

dh) Janë lidhun me Komitetin Ballist ne Prizren per ta ndihmue njani tjetrin dhe kanë pas per qellim te lidheshin me Komitetet Suharek-Gjakovë.

e)Për me forcue organizatën e tyre tradhtare kane bame betimin qe do te luftojnë kundra regjimit te sotshem deri në pikën e fundit te gjakut dhe që nuk kanë me tradhëtue komitetin qe kanë kriju vet. Ne raste se do kush prej tyre e tradhton komitetin nuk e pret gjë tjetër vetem se vdekja e sigurt, kete betim e kanë bame te gjithë të pandehurit.

Pra kanë krijuet një organizatë e cila ka beme një propagandë gneshtare, kanë bame agitacion me armatos njerëz per me pergadit një luftë të armatosun, janë lidhë dhe kanë ndihmue bandatë e arratisuna te gjitha keto me qellim qe me anë të forcës ta shkatërrojnë themelet fillestare të Jugosllavisë D.F Përveç kësaj Ahmet Dërguti në pranverën e vjetit 1945 si intendent i komandes së vendit në Rahovec, tue punue aktivisht per komitetin ne te cilin bante pjesë ka grumbulue ndihma per bandat e arratisuna balliste tue tërheq prej magazine es ushtarake 2.000 kg drithë dhe 200 kg. Leshë.

VI.

Rexhep Abdullah Kabashi i quaj-tun "Tomorri" per se ne fillim dhe deri ne gjysmën e vjetit 1945 ka marr lidhje dhe me ne kontakt me te pandehurit Tahir Deda. Mbasi kanë ranë në dakord asht bame vegël dhe ndërldhje kryesore e Tahirrit me kryetarët e bandave të arratisuna te cilat ne atë kohë luftofshin me Drenicë kundra UNÇ. Ka dergje postën qe i pandehuri Tahir Deda e drejtonte Bandave t'armatosuna ne adresë te Prof. Ymer Berishës, i cili i përgjegjte te pandehunit Tahir dhe kur posta ose letra nuk kishin mundësi me depertue per shkak të luftës atëherë i pandehuni Rexhep i çilte dhe i këndonte e mandej përmbajtjen e tyre ja referonte te pandehurit Tahir dhe anasjelltas simbas udhëzimeve te dhanuna

gojarisht prej Tahirrit, Rexhepi i shkruante personalisht Ymer Berishës.

Pse si sekretar i Këshillit Popullor te komunës në Lubizhdë, tue përfitue nga pozita ka keqpërdorun dhe abuzue me detyrën e tij, tue mbledhë shenime dhe informata mbi ushtrin tonë, mbi forcat e saja dhe lëvizjen e saj tue ja dergje Tahir Dedës, tue qenë i sigurt dhe tue dijte fortë mirëse ai banë pjesë ne një organizatë ilegale e si e tillë asht i lidhun me bandat arratisuna, përmbajtjen e këtyre shenimeve e informatave e dergonte ose e përcillte tek bandat ne fjalë. Pra, ka bamun spiunimin ne dam te shtetit dhe në favor te bandave të arratisuna kundershare te regjim-it të sotshem.

VII.

Kadri Ramadan Topalli per se si pjesëtarë i organizatës balliste e cila ka pas për qëllim kryesuer përmbysjen e regjimit të sotëm të Jugosllavisë D.F ka ra në kontakt e ne lidhje me bandat e arratisuna dhe ka mbajtur lidhjen mes te ketyre dhe komitetit ballist në Prizren dhe gjithashtu me Kitetin femnuer ballist, tue i vue në lidhje direkte e kontakte keto organizata me bandat e arratisuna , tue dergje postat, informatat dhe tue prue prej tyre posten dhe udhëzimet, tue dergje material te mbledhun ne qytet bandave në fjalë, si për shembull bombë dore municion pushke e tj. Pse në muajin maj te këtij viti ka shoqënuet dhe fute ne Prizren Kaptan Riza Aliun një nder kryetaret e bandave, ka asistu ne konferenca dhe e ka vue ne kontakt me komitetin ballist te rrethit të Prizrenit. Per qe ka përcjell Laura Shmanin dhe Nesibe Zhurin qe keta te takohen me bandat ne mal dhe pse ka përcjell drazhisten e të arratsun Milla Bilibajkiq ne banden balliste.

Per sa u tha ma sipër dhe në bazë te nenit 4, pika 1, nenit 6, pika 1, nenit 3, pika 1 e 7 dhe nenit 11 te Ligjit krimet kundra popullit e shtetit dhe zbatimin e tij dt. 9 korrik 1945.

Shqiptohen dënime drakonike për anëtarët e KNDSH-së

GYJKON

I. Të pandehunit:

Halim Spahin, Tahir Dedën, Rifat Krasniqin, Sefedin Ahmetin, Rexhep Avdullah Kabashin dhe Kajtaz Ramadanin me dënimin e vdekjes me pushkatim dhe dënimin e humbjes te përhershme te gjithë të drejtave politike e qytetare dhe me konfiskimin e tana pasurive te tyne.

II. Të pandehunit:

Ahmet Dërgutin, Kadri Minushin dhe Xhemil Flukun me dënim te humbjes së të drejtave se lirikes dhe me punë të detyrueshme te

vazhdueshme 20 (njizetvjet) me kushte qe ka me ju llogarit prej ditës së arrestimit dhe me humbjen e të drejtave politike dhe disa te drejtave qytetare, përveç të asaj princore ne vazhdim prej 10 vjetesh që do të llogariten mbasi kryhet dënimi.

III. I pandehuri Maliq Balijs me dënim humbjen e të drejtave te lirisë dhe me punë të detyrueshme me vazhdim prej 17 (shtatëmbdhjet) vjetë, me kushtë qe ti llogaritet ndeshkimi nga data e arrestimit dhe me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare përveç asaj te prindërve me vazhdim prej 8 vjetësh e cila ka me u llogarit mbas kryemjes së dënim-it.

IV). I pandehuni Abdul Rexhepi me dënim humbje lirie dhe pune të detyrueshme te vazhdueshme prej 12 vjet (dymbdhjet vjet) me kusht që dënimi ti llogaritet prej datës se arrestimit, dhe me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare përveç asaj princore, te vazhdueshme prej 5 vjete qe do te llogariten mbas kryemjes së dënim-it.

V). I pandehuri Kadri Ramadani me dënim humbjen e lirisë dhe me punë te detyrueshme te vazhdueshme per 10 vjet (dhjetë vjetë), me kusht që dënimi ti llogaritet prej datës së arrestimit dhe me dënim te humbjes të drejtave politike e disa qytetare përveç asaj princore te vazhdueshme per 5 vjet, q ka me ju llogarit mbasi te kryej burgimin.

VI). I pandehuni Fehim Ibrahim me denim te humbjes te lirisë dhe punë të detyrueshme te vazhdueshme 8 vjete (tetë vjete) me kusht qe ti llogaritet dënimi prej datës së arrestimit dhe me dënim humbjen e të drejtave civile përveç atyne princore te vazhdueshme per 4 vjet qe ka me u llogarit mbasi te kryej ndëshkimin.

VII). I pandehuri Basri Sallku Boshnjaku me dënim te humbjes se lirisë dhe punë të detyrueshme

te vazhdueshme prej 7 vjetesh (shtatë vjetësh) me kusht qe tu llogaritet denimi prej datës së arrestimit dhe me dënim të humbjes të drejtave civile dhe disa qytetare përveç asaj princore te vazhdueshme per tre vjet qe ka me u llogarit mbasi te kryej dënimin.

VIII). I pandehuri Vahit Mustafa me dënimhumbje lirie e pune të detyrueshme te vazhdueshme per 4 (katër) vjet, me kusht qe denimi ti llogaritet qe nga data e arrestit dhe me humbje en e të drejtave politike e disa qytetare përveç të asaj princore te vazhdueshme prej dy viteve qe ka me u llogarit mbasi te kryej dënimin.

IX). Të pandehurit Abdullah Hajrullahu, Abdullah Hamëza, Sadik Peqani e Qamil Emini me dënim humbje lirie e pune të detyrueshme te vazhdueshme per një vit, me kusht tu llogaritet qysh nga data e arrestimit.

X). Të pandehurit Hasan Rustemi e Sheh Muhedini me denim humbje lirie dhe pune të detyrueshme të vazhdueshme per një vjet ndeshkim i cili pezullohet me kon-dita 2 vjeçare.

XI). Lirohen nga aktakuza të pandehurit Sinan Hazëri, Ruzhdi Kabashi, Ibrahim Abdyli dhe Muhamet Veseli per munges provash dhe urdhërohet lirimi i tyre ne mos kjo fshin të ndalun per shkak tjetër.

Ky vendim epet me të drejte apeli-mi me afat 8 ditë.

Vdekje Fashizmi-Liri popullit Prizren 27 .IX. 1945.

Sekretari; M. Biçoku
Anëtar; Kolë Shiroka
Anëtar; Qamil Brovina
Kryetari; Hivzi Sylejmani

Mbas deklarimit të këtij vendimi, kryetari i shpjegoi shkurtazi te denuemve te grupit: I dispozitat e neneve dhe i porosit qe te tregojn durim, dhe ne se duem brenda 8 ditve munden me paraqitun ndonji parashtres e cila ka me u bashkue me aktet relative qe kane

me ju dergje per shqyrtim Gjykatës se nalt kompetente.

Prizren , me 27 .IX. 1945.

Sekretari; M. Biçoku

Kryetari; H. Sylejmani

U pyeten të pandehunit e denume te gjithë me një za deklaruen se do te ankohen, tue paraqite parashtresat e apelimit prane Gjykatpës Kompetente.

Ne kete menyë ju njohtue te pandehunvet te dendem se afati i tetë ditëve qe bahet fjalë siper ka me fil-lue prej datës se dorëzimit të akt-gjykimit me diftues te rregullt.

Prizren, me 27.IX. 1945.

Sekretari; M. Biçoku

Kryetari; H. Sylejmani

EDHE GRATË SHQIPTARE NË BURGJET JUGOSLLAVE


Në procesin gjyqësor që u orga-nizua kundër Halim Spahisë me shokë prej 34 (tridhjetekatër vetave), në këtë proces dolën edhe 9 (nëntë) gra, që ishin anëtare të Organizatës Nacional

Demokratike Shqiptare. Frika nga masa e tubuar që ishte mbledhur para sallës së kulturës në Prizren, me 27 shtator 1945, i detyroi pushtetarët dhe gjykatësit, që këtë proces makabër gjyqësor ta ndajnë në dyshë.

Me 27 shtator u mbajt seanca e fundit e Halim Spahisë me shokë, ndërsa me 22-23 tetor 1945, u mbajt seanca përfundimtare kundër grupit të grave që e për-bënin nëntë veta.

Në emër të popullit

Gjykata Popullore e Krahinës, në Prizren, e formuar prej kryetarit të Gjyqit- Hivzi Sylejmani, kryetar i kolegjiutit, me gjyqtarët e popullit: Predrag Ajtiq, e Ahmet Nallbanin si anëtar të kolegjiutit. Ndërsa në seancë asistonte edhe sekretari Mustafa Biçoku, në çësht-jen penale kundra të akuzuarave Laura Shmani e të tjerave nga Prizreni. Në bazë të aktakuzës të Prokurorit Publikë për Kosovë K. Nr. 202/45, dt. 12. X. 1945, për faje të parapara me nenin 6 të Ligjit mbi fajet kundër popullit dhe shtetit. Mbasi ishte mbajtur seanca kryesore publike në Prizren me dt. 22-23 tetor 1945, në prezencën e të akuzuarave dhe të Zëvendës Prokurorit Publik për Kosmet, Radoja Vukçević, dhe mbasi ishte dëgjuar aktakuza përfundimtare e zëvendës Prokurorit Publik, që kërkohej me këmbëngulje që të arrestuarat të shpallen fajtores dhe të dënohen sa më rëndë. Pas shumë ditëve të kaluara në hetuesi, pas shumë torturave që ishin përdor ndaj tyre dhe pas shumë shantazheve që iu kishin bërë, më në fund të dënuarave iu shqiptua dënimi nga gjykatësi. (Vijon)



Fjalim i mbajtur në një nga sallat e ndërtesës së Kontrollit të Lartë të Shtetit në Tiranë

FEHMIU DHE XHEVA I KANË TEJKALUAR TË GJITHA FIGURAT E MËDHA TË LUFTËTARËVE TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT



Ismet SYLEJMANI

*I nderuar kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj!
I dashur Bedri Islami, shoku dhe bashkëveprimtari i gjeneral Fehmi Lladrovci dhe heroinës Xhevë!
Të dashur pjesëtarë të familjeve të Fehmiut e të Xhevës, i dashur Ramiz Lladrovci!*

I nderuar përfaqësues i Ambasadës së Kosovës, ambasador Syl!

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj!

22 shtatori i vitit 2018 shënoi 20-vjetorin e rënies heroike të veprimtarit të madh kombëtar, ilegalit me konspiracion të çeliktë, organizatorit dhe udhëheqësit të shkëlqyer të lëvizjes kombëtare politike klandestine në Kosovë, kryetarit të Lëvizjes Popullore të Kosovës në Gjermani, gjeneralit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare Kosovës të popullit shqiptar, komandantit historik të Drenicës, heroit të kombit, të lavdishmit Fehmi Lladrovci dhe bashkëshortes e bashkëluftëtares së tij, heroinës Xhevë!

Populli shqiptar në Kosovë dhe viset e veta në ish-Jugosllavi në historinë e përpjekjeve dhe të luftës titanike për largimin nga Kosova të Serbisë pushtuese, Fehmi Lladrovci e ka pasur njërin prej bijve më të mëdhenj, më të lavdishëm dhe shumë të veçantë! Heroi i kombit Fehmi Lladrovci është në mesin e pesësoshes së madhe që me heronjtë e kombit Rexhep Malaj e Nuhi Berisha, Shaban Shala dhe udhëheqësi i popullit shqiptar, Ali Ahmeti, formuan Partinë e Luftës së Kosovës, paralajmëruesen e ardhjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrive të tjera çlirimtare. Hallkë e madhe që lidhte dhe mbante shumë fije ishte burri i kombit, Fehmi Lladrovci.

Sikur Fehmiun, të rrallë, shumë të rrallë i ka pasur dhe do t'i ketë bijtë atdheu ynë!

Udhëheqës i vendosur, besnik, i dashur dhe i qeshur me shokë e bashkëveprimtarë, me ushtarë e bashkëluftëtarë, i ashpër deri në pakufi me pushtuesit e atdheut, me armiqtë dhe tradhtarët.

Heroi i kombit, Fehmi Lladrovci,

është emblema lavdimadhe e figurës së shqiptarit inteligjent, të panënshtuar e i aftë dhe i vendosur për ta drejtuar popullin në luftë për liri kundër Serbisë pushtuese.

Fehmiu dhe Xheva i kanë tejkualuar të gjitha figurat e mëdha të luftëtarëve të çlirimit të atdheut.

Në fillim të jetës së tyre vepruan në hapësirat e Drenicës heroike e të panënshtuar, pastaj e nisën zgjerimin e rrethit të ndikimit të tyre të madh kudo nëpër atdhe dhe jashtë kudo nëpër botë.

Fehmiu dhe Xheva burgosjet dhe dënimet e mëdha të gjyqeve anti-shqiptare në Kosovë e vise në ish-Jugosllavi i kthyen në evenimente, ku dashuria ndaj çështjes kombëtare u rrit në mënyrë enorme.

Fehmi Lladrovci dhe Xheva u bënë personazhe të mëdha, të paarritshme përgjithmonë nga brezat që vijnë sepse, përpos vlerave të reja e të mëdha që i sollën lëvizjes politike ilegale të organizuar, ata u martuan në rrethana të paimagjinueshme.

Fehmi Lladrovci në burg e Xheva shkoi nuse në shtëpinë e Fehmiut, kjo ishte ngjarje që kapërceu të gjithë kufijtë e normales, të gjithë kufijtë e dashurisë njerëzore, të gjitha praktikat u thyen dhe u tejkualuan, edhe me martesë të tillë Fehmi Lladrovci dhe Xheva e tij heroinë dhe trimëshë, u përcaktuan edhe më fuqishëm në luftë kundër Serbisë.

Fehmiu dhe Xheva, kudo që ishin, veprimtarinë patriotike për çlirimin e Kosovës, jo vetëm nuk e ndalën e nuk e ulën, por e rritën dhe e pasuruan me gjithçka, edhe luftën e armatosur kundër Serbisë pushtuese e bënë edhe në Kroaci, ndërkohë që përgatitjet për të filluar lufta e armatosur çlirimtare në Kosovë i kishin të pandërprera. Fehmiu dhe Xheva morën pjesë në dy luftëra, pra dy herë luftuan



me armë në duar kundër Serbisë pushtuese, herën e parë në Kroaci, herën e dytë në atdheun e tyre në Kosovë dhe kaluan në përjetësi.

Të jesh shok e bashkëveprimtar me Fehmi Lladrovci dhe bashkëshorten e tij Xheven, pa dyshim se ishte nder e respekt i madh, por edhe përgjegjësi, sepse ata jetën e kishin jo për vete, por për atdheun dhe çlirimin e pavarësinë e tij nga pushtuesit.

Autori i librit "Përjetësia e dyfishtë", shkodrani i madh i Shqipërisë Nënë, djali i personazheve të famshme të Migjenit, "Luli i Vocërr" dhe "Zenelit", nipi i Gjylbegajve të Shkodrës, i nderuari Bedri Islami, është rast i rrallë që librin e shkruan për figura që kanë të kaluar jo vetëm heroike e legjendare, por edhe i tejkalojnë përmasat e zakonshme të personazheve, sepse ata janë të gjithanshme, janë figura kombëtare e ndërkombëtare, janë me kontribute të shumta, si në veprimtarinë kombëtare, si në luftën dhe organizimin e mirëfilltë të lëvizjes ilegale politike patri-

otike, si në qëndresën kombëtare nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë, si në ndihmën e madhe në organizimin dhe pjesëmarrjen në luftën e armatosur për çlirimin e Kroacisë nga Serbia hegjemoniste dhe krejt në fund, për luftëtarin dhe komandantin e strategun e lavdishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjeneralin lavdimadh e syptrembur Fehmi Lladrovci dhe bashkëshorten e Fehmiut, luftëtarin dhe komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, heroinën e kombit Xheva Krasniqi-Lladrovci.

Autori i librit "Përjetësia e dyfishtë", shkrimtari i talentuar, kryetari i famshëm i Lëvizjes Popullore të Kosovës, Dega Jashtë Vendit, në kohën e luftës së lavdishme e historike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shoku e bashkëveprimtari i personazheve, i nderuari Bedri Islami, nuk ka shkruar një libër dosido, por ka shkruar një libër monument, sepse personazhet e tij janë të pavdekshëm jo vetëm pse kanë derdhur gjak e kanë dhënë jetë për

lirinë dhe çlirimin e atdheut, por nuk kanë lënë gjë pa bërë e gjithçka që ka qenë njerëzore, që atdheu të bëhej i lirë dhe i pavarur nga Serbia pushtuese.

Çlirimi nga Serbia pushtuese i Kosovës ishte ëndrra, ishte jeta, ishte shëndeti, ishin fëmijët, ishte e ardhmja, ishte ideali madhor i personazheve epike të shkrimtarit Bedri Islami. Edhe të tjerë personalitete të mëdha të letrave kanë shkruar e do të shkruajnë për Fehmiun e Xhevën, pasi për këto dy figura do të jenë gjithmonë të interesuara emrat e mëdhenj ta thonë fjalën e tyre, por si Bedri Islami askush deri më sot nuk ka arritur t'i gdhendi e t'i dërgojë te çdo lexues, në çdo bibliotekë, ashtu sikur ishin në origjinal dhe do të dëshiroja që Bedri Islami të mos tejkalohej, pasi edhe nëse do të tejkalohej artistikisht, që dyshoj se nuk bëhet dot, por shpirtërisht askush nuk do t'i admirojë e nuk do të shkruajë me loçkë të zemrës e të shpirt, me lot në sy e me ofshama të njëpasnjëshme dhe me net të tëra të pagjumë, nga dhembja për shokët dhe nga merak se a do të arrijë ta thotë tërë atë që e ndiente për ta.

Bedri Islami, se sa shumë e ka dashur e se sa shumë është hidhëruar e mërzhitur për rënien heroike të Fehmiut e Xhevës, thotë "...po të ishte e mundur, datën 22 shtator të vitit 1998, do ta kisha hequr nga të gjithë kalendarët e botës..."

Populli shqiptar dhe atdheu e kombi ynë e kanë pasur për nder që ta ketë djalë të vetin heroinë e kombit Fehmi Lladrovci dhe bijtë të sajën heroinën e kombit Xheva Krasniqi-Lladrovci.

Lavdi e përjetshme Fehmiut dhe Xhevës!

Suksese e vepra të reja, shkrimtarit të talentuar e shqiptarit të madh Bedri Islami!

Prishtinë, 19 nëntor 2018



Spanja kërcënon me votim kundër marrëveshjes për Brexit

MADRID, 20 NËNTOR - Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, ka thënë se Spanja do të kundërshtojë një draft marrëveshje për Brexitin pa u qartësuar në tekst për bisedimet e së ardhmes për statusin e Gadishullit të Gjibraltarit. Spanja ka pretendime për këtë Gadishull, i cili i është dorëzuar kurorës britanike sipas Traktatit të Utrehtit më 1713. Prandaj ky shtet kërkon të sigurohet se bisedimet në të ardhmen në mes të BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar nuk përfshijnë këtë Gadishull. "Nëse gjërat vazhdo-

jnë kështu dhe nuk ka ndryshime për Gjibraltarin, Spanja do të votojë kundër Brexitit", ka thënë Sanchez. Përgjatë negociatave për Brexit, Spanja, së bashku me Irlandën dhe Qipron, kanë zhvilluar bisedime të ndara me Mbretërinë e Bashkuar lidhur me çështjet kufitare. Ministri i Jashtëm spanjoll, Josep Borrell, ka thënë se marrëveshja për Brexit ka dështuar që të qartësojë se bisedimet për Gjibraltarin përbëjnë "negociata të ndara" dhe nuk janë pjesë e bisedimeve në të ardhmen në

mes të BE-së dhe Britanisë. Sanchez ka vënë theksin në këto deklarata në një forum që është mbajtur të martën në Madrid, duke thënë se negociatat e ardhshme për Gjibraltarin duhet të jenë bilaterale. "Si shtet nuk mund të sigurojmë se çfarëdo që ndodh në të ardhmen me Gjibraltarin do të negociohet nga Britania dhe BE-ja, sepse duhet të negociohet në mes të Spanjës dhe Britanisë", ka thënë ai. Në referendumin e 23 qershorit më 2016, 17.4 milionë persona apo 51.9 për qind e votuesve



kanë përkrahur largimin nga BE-ja derisa 16.1 milionë të tjerë apo 48.1 për qind të tjerë kanë

votuar kundër Brexitit. Britania pritet të largohet nga blloku evropian në mars të vitit 2019.

Blokohet urdhri i Trumpit për azilin



Gjykatësi Jon Tigar në San Francisco bllokoi urdhrin e lëshuar nga presidenti Donald Trump për t'ua mohuar azilin migrantëve që kalojnë kufirin jugor të ShBA-së në mënyrë të paligjshme

WASHINGTON, 20 NËNTOR - Një gjykatës federal në Shtetet e Bashkuara e bllokoi urdhrin e lëshuar nga presidenti Donald Trump për t'ua mohuar azilin migrantëve që kalojnë kufirin jugor të ShBA-së në mënyrë të paligjshme. Gjykatësi Jon Tigar në San Francisco lëshoi urdhrin e përkohshëm të ndalimit pas

dëgjimit të argumenteve nga grupet e të drejtave civile. Trumpi e nënshkroi urdhrin e tij më 9 nëntor, në përgjigje të një karvani migrues që po lëviz drejt kufirit. Trumpi përmendi shqetësimet për sigurinë kombëtare, por u kundërshtua nga grupet e të drejtave civile, të cilat e dërguan rastin në

gjykatën në San Francisco, duke thënë se vendimi i tij ishte i paligjshëm. Gjykatësi Tigar, në vendimin e tij, tha se legjislacioni aktual e bën të qartë se çdo i huaj që hyn në ShBA, "pavarësisht nëse është apo jo në një port të caktuar të mbërritjes", mund të aplikojë për azil. Gjykatësi, po ashtu, tha se presidenti nuk mund t'i rishkruajë ligjet e imigrimit, duke imponuar një kusht, që Kongresi e ka ndaluar shprehimisht. Mijëra migrantë nga Amerika Qendrore kanë udhëtuar për

javë të tëra drejt kufirit Meksikë - ShBA. Ata thonë se ikin nga përndjekja, varfëria dhe dhuna në vendet e tyre: Honduras, Guatemalë dhe El Salvador. Trumpi ka thënë më herët se shumë prej migrantëve janë kriminelë, karvanin e ka cilësuar si pushtim, ndërsa ka dërguar trupa në kufi. Me urdhrin e 9 nëntorit, ai ka kërkuar që secili që dëshiron të kërkojë azil në ShBA, duhet të hyjë nëpër pikat zyrtare të hyrjes. Me urdhrin e tij, rastet e atyre që hyjnë ilegalisht, nuk do të dëgjoheshin.

Ndalimi do të zgjaste 90 ditë ose derisa ShBA-ja të arrinte një marrëveshje me Meksikën për t'i kthyer azilkërkuesit. Sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara, ekziston një detyrim ligjor për t'i dëgjuar kërkesat për azil nga emigrantët nëse ata thonë se kanë frikë nga dhuna në vendet e tyre - pavarësisht se si kanë hyrë në ShBA. Pjesëmarrësit e karvanit kanë filluar të arrijnë javën e kaluar në Tijuana, qytetin në anën meksikane të kufirit. Trumpi ka dërguar më shumë se 5 000 ushtarë në kufi.

Dodik pritet ta marrë Presidencën në Bosnjë dhe Hercegovinë

SARAJEVË, 20 NËNTOR - Nacionalisti serb Milorad Dodik do ta drejtojë Presidencën trepalëshe të Bosnjë e Hercegovinës, teksa ky shtet inauguron udhëheqjen e re. Të tre presidentët ndërrojnë karri- gen e udhëheqësit çdo tetë muaj sipas Marrëveshjes së Dejtonit për paqe që i ka dhënë fund

luftës në këtë shtet. Sipas marrëveshjes, fuqia udhëheqëse është ndarë në tri grupe, për myslimanët boshnjakë, serbët e Bosnjës dhe kroatët. Votuesit kanë zgjedhur në mua- jin tetor përfaqësuesit e tyre, derisa Dodik, politikan pro-rus, do ta bëjë betimin në pozitën e re më 20 nëntor. Dodik,

përndryshe është goditur me sanksione ekonomike nga Shtetet e Bashkuara. Në këtë ceremoni do të betohen edhe presidenti i myslimanëve boshnjakë, Sefik Xhaferoviq dhe presidenti kroat, Zheko Komshiq. Banorët e këtij shteti presin pak ndryshime pas këtij rezultati

zgjedhor, meqë janë rritur tensionet në mes të myslimanëve boshnjakë dhe zyrtarëve serbë në këtë shtet. Votimet e muajit tetor kanë ndodhur në një periudhë të rëndësishme, pasi rezultati është konsideruar përcaktues i vazhdimit të thellimit të marrëdhënieve të këtij shteti me




Bashkimin Evropian dhe NATO-n ose ngecje në këtë proces.

E rrallë

77-vjeçarja blen tiketë për herë të parë, e fiton lotarinë

Një grua 77-vjeçare nga Mariland fitoi 10.410 dollarë në lotari, pasi e provoi fatin për herë të parë në jetën e saj. "Gjyshja fatlume", ashtu siç e quajnë tani, u ka thënë zyrtarëve të lotarisë se zakonisht më parë luante vetëm me tiketa gërvishtëse lotarie, duke e provuar



fatin rreth dy herë në javë, por më pas kishte vendosur që në një pompë benzine ta blinte tiketën e lotarisë në vlerë prej dy dollarësh dhe i përzgjedhi numrat 3-7-9-4, të cilët e bënë fituese të Jackpotit.

FOTO E DITES

Një fëmijë shihet duke ngrënë në një qendër të personave të zhvendosur në Juba të Sudanit të Jugut. /AP/

E jashtëzakonshme

Ylli i Hollywoodit paguan kreditë e fermerëve me vlerë 500 000 dollarë

Ylli i Hollywoodit, Amitabh Bachchan, ka paguar kreditë e fermerëve në Indi me vlerë më shumë se 500 000 dollarë. Ai ka shkruar në blogun e vet të martën se kishte marrë nën kujdesin e tij 1 398 fermerë duke ua paguar borxhet. Të gjithë



fermerët janë nga shteti verior i Uttar Pradesh, ku Bachchan ka lindur. Dhjetëra fermerë indianë "luftojnë" me borxhet që kanë.

BARSOLETA E DITËS


Pacienti: - Doktor, kam shumë stres, sepse është hera e parë që bëhem operacion!
Doktori: - Edhe unë kam, sepse është hera e parë që operoj pacient.

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC****“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Edhe durimi juaj e ka një limit, por kjo gjë nuk po kuptohet ende mirë nga ata që ju qëndrojnë pranë.

**DEMI**

Jeni përqendruar në një pikë të caktuar dhe do të neglizhoni çdo gjë tjetër rreth jush. Një darkë romantike me partnerin do t'ju kënaqë.

**BINJAKËT**

Shumë çështje mund t'i injoroni sot, por njëra në veçanti është shumë e rëndësishme për t'u lënë mënjane.

**GAFORRJA**

Sot mund të ketë shumë keqkuptime që lidhen me sjelljen tuaj hipersensibël dhe me emocionet e dukshme.

**LUANI**

Sot do të kuptoni se pse persona të caktuar kanë kohë që janë larguar nga ju për shkak të sjelljes suaj.

**VIRGJËRËSHA**

Jeni pak nostalgjik sot për shkak edhe të kohës, por kujtimet e bukura do të jenë të vetmet që ju vijnë në mend.

**PESHORJA**

Nëse e nisni ditën me këmbën e mbarë, sot do të keni vetëm lajme të bukura gjatë gjithë kohës në vazhdim.

**AKREPI**

Për të vendosur të ardhmen tuaj duhet t'i zgjidhni patjetër problemet që keni me të tashmen që s'po ju lënë të qetë.

**SHIGJETARI**

Jini më i pranishëm në jetët e personave që doni sepse do të vijë momenti dhe nuk do ta gjeni më vendin tuaj.

**BRICJAPI**

Sot jeni shumë pesimist sepse keni parë që bashkëpunëtorët tuaj po mundohen ta zvogëlojnë sa të mundin punën që ju bëni.

**UJORI**

Keni një situatë komprometuese që mund t'ju shqetësojë sot. Por, nëse veproni me natyralitet, çdo gjë do të zgjidhet më së miri.

**PESHQIT**

Sot mos u mërznisni nëse personat pranë jush nuk do t'ju thonë ato që doni të dëgjoni. Më mirë t'ju thonë të vërtetën.

Heather Locklear shtrihet në spitalin psikiatrik



Heather Locklear ka përfunduar sërish në një spital psikiatrik, pasi ka pësuar një thyerje nervore në shtëpinë e saj në Los Angeles. Ylli i "Melrose Place" është pranuar në spital më 19 nëntor, pasi

terapisti dhe avokati i saj kanë ardhur në përfundim se ajo ka nevojë për ndihmë mjekësore. Nuk dihet nëse thyerja nervore që aktorja ka pësuar së fundmi ka të bëjë me konsumimin e alkoolit.

Bella dhe The Weeknd u shmangen paparacëve



Bella Hadid dhe The Weeknd thuhet se janë duke e ndarë bashkë një apartament në Tribeca të Manhattanit të cilin e paguajnë 60 mijë dollarë në muaj. Ndërkaq të hënën ata tentuan t'u shmangen paparacëve teksa dolën

për kafe në Mollën e Madhe. Që të dy ishin veshur në të zeza dhe ecnin rrugëve të Nju Jorkut, vend në të cilin duket se po jetojnë "përkohësisht". Të dy ka muaj që janë kthyer në krahët e njëri-tjetrit pas ndarjes të cilën e kishin përjetuar vite më parë.



Laura Crane, mahnitëse pasi mposhti sëmundjen

Ikaloi dhjetë ditë në spital pasi u prek nga sepsisi, megjithatë Laura Crane duket të jetë rikuperuar tërësisht. Ylli britanik i shout "Love Island" shfaq buzëqeshjen e ëmbël dhe format

e bukura trupore në paraqitjen e saj në Londër këtë të hënë. Ajo ishte pjesë e Nordoff Robbins Boxing Dinner dhe nga fotografitë e shkrepura, Laura dukej më mirë se kurrë.


Reperi përballet me burgim të përjetshëm

Reperi i famshëm Daniel Hernandez, i njohur edhe si Tekashi 6ix9ine, mund ta kalojë gjithë jetën në burg pas akuzave të ngritura kundër tij në Gjykatën Federale të hënën. Sipas një dëshmitari okular, reperi u shfaq në gjykatë me duart dhe këmbët me pranga. Ai përballet me gjashtë akuzat: komplot me të tjerët për të bërë shantazh, qëllimin me armë zjarri ndërsa kryente një krim, dhunimin me anë të shantazhit, sulm me armë të rrezikshme, mbajtja e një arme zjarri



dhe kryerja e një krimi me ndihmën e shantazhit. Dy nga akuzat kundër Tekashit kanë një dënim maksimal me burgim të përjetshëm.

60 vjet nga 'Gjarpijt e gjakut' dhe burgosja e parë e Adem Demaçit



Lulëzim ETEMAJ

Jo - atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por - atyne që janë trima me zgjatë dorën e pajtimit.

Kjo është motoja e romanit "Gjarpijt e gjakut" (titulli i originalit), romanit të parë të Adem Demaçit, njëherit romanit të parë shqiptar në Kosovë, të botuar në vitin 1958, fillimisht në numrin 1 dhe 2 të revistës letrare "Jeta e re", nën përkujdesjen shembullore të Esad Mekulit, njërit prej mbështetësve më të guximshëm të penave të reja të letërsisë shqiptare që, për shkaqe politike, po hidhte hapat ngadalshëm në Kosovë. Romani i Demaçit, "Gjarpijt e gjakut", pararendëse i ka vitet e egra të dhunës dhe represionit të pushtuesit mbi shqiptarët, posaçërisht të policisë së drejtuar

prej Aleksander Rankoviçit, i cili eskalon sidomos gjatë viteve 1956 dhe 1957 të aksionit famëkeq të grumbullimit të armëve, për t'i detyruar ata që të shpërnguleshin në Turqi. Si pasojë e torturave barbare, humbën jetën 100 persona, ndërsa me pasoja fizike dhe psikike mbetën për jetën 30 000 të tjerë. Me numrin prej 41 800 shqiptarëve të shpërngulur vetëm në vitin 1958, 54 000 në vitin 1956 dhe 57 710 në vitin 1958, numri i përgjithshëm i shqiptarëve të shpërngulur dhunshëm vetëm gjatë këtyre tre vjetëve arrin shifrën prej 153 510 vetave.

Kjo kohë e rëndë, kohë të cilën po e jetonte populli i shtypur shqiptar, është bërë objekt i trajtimit specifik, krejt original, duke iu nënshtuar pasqyrimin artistik, psikologjik e filozofik të Demaçit, duke e bërë romanin "Gjarpijt e gjakut" të jetë tejet i veçantë - roman metaforë për nga struktura e tij estetike. Roman që, sado që duke qenë i veshur me shije me petkun letrar, ishte në të vërtetë një mesazh i fortë politik kombëtar, drejtuar bashkëkombësve,

mesazh që ngërthente thirrjen, klithmën për t'i braktisur konfliktet mes tyre, veçanërisht gjakmarrjen, dhe bashkuar të gjitha energjitë kundër pushtuesit të vendit.

"Jo - atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por - atyne që janë trima me zgjatë dorën e pajtimit". Ky është mendimi bosht i romanit, të cilin e bartë Mustafa, si personazh, i cili, në të vërtetë është vetë Adem Demaçi. Demaçi, që duke parë se si gjarpërinjtë e gjakut, gjarpërinjtë e gjakut tonë së bashku me gjarpërinjtë e sistemit të pushtuesit, duke ia marrë gjakun, po e varfëronin dhe rrezikonin jetën e shqiptarëve, substancën dhe mbijetesën tonë kombëtare në trojet tona shekullore, duke qenë i pakromis, fton fuqishëm popullin, posaçërisht rininë shqiptare, për t'i dhënë fund vëllavrasjes: "Mëshoj edhe pak, mëshoj e naljau turrin këtyne gjarpnoje t'gjakut, qi po mundohen hala me ecë e me i përlye me marre kto malet tona, me e flliqë këtë dhe t o n i n ! . . . - Ndalni!....Ndalni!...Shtypjauni kryet!...".

Ky mendim bosht i romanit, përkatësisht filozofia çlirimtare e tij, i siguroi Demaçit mirëpritje të matur në qarqet letrare të kohës, kurse nga ana e lexuesve të shumtë, posaçërisht te rinia, e cila po e ndiente më shumë se çdokush tjetër përcëllimën e vapën ekzistenciale, që Bucinën e kishte bërë trokëllimë, kurse barin e kishte zverdhë dhe njerëzit, shqiptarët, i kishte "teshur në shpirt", ardhja e tij ishte prituri si ardhja e shiut prej kupës së qiellit, të cilit i ishin lutur në gjuhën shqipe, herë më zë e herë në heshtje, duke drejtuar sytë e lodhur prej tij.

"Gjarpijt e gjakut" është romani që i shqiptoi dënimin vendimtar gjakmarrjes, njëkohësisht paraqet akuzë kundër shoqërisë, e cila nuk po ndërmerre asgjë për çrrënjosjen e saj. Kështu ai ishte lexuar edhe prej pushtetit. Prej pushtetit politik dhe prej të gjitha policive të tij, përfshirë edhe policinë ideore. Dhe, për pasojë, autorin Adem Demaçi e burgosin po këtë vit, më 19 nëntor, ndërsa vitin tjetër, në muajin shkurt, e nxjerrin para Gjyqit të Qarkut në Prishtinë dhe "në


emër të popullit" e dënojnë me pesë vjet burgim të rëndë.

"Prej këtu ku jam po ju them edhe një herë se nëse Serbia e Jugosllavia nuk heqin dorë nga okupimi i Kosovës dhe nëse nuk lejojnë që Kosova të shkëputet nga Jugosllavia e t'i bashkohet Shqipërisë, atëherë nuk do të ketë paqe as në Ballkan, as në Jugosllavi, as në Sërbë", deklaroi Demaçi para këtij gjyqi antishqiptar në mbrojtje të pikëpamjeve të veta politike dhe të të drejtave të ligjshme të shqiptarëve të Kosovës.

Ky deklarim i Adem Demaçit para gjykatës në Prishtinë paraqet në të njëjtën kohë hapjen botërisht të siparit të burgjeve dhe të rezistencës së tij të pathyeshme politike kombëtare kundër pushtuesit, me epilogun tashmë të ditur: 28 vjet burgim të vuajtura; gjarpinjtë e gjakut, kokështypur; dhunë, terror e gjenocid të ushtruar nga Serbia në Kosovë kundër shqiptarëve dhe luftë mbinjerëzore çlirimtare e UÇK-së, luftë që solli çlirimin, lirinë, shtetin e Kosovës dhe perspektiva të reja të përmbushjes së idealit të heroit Adem Demaçi - bashkimit kombëtar.

A KA HI FJALA?

(Ragip Sylaj, "Hiri i fjalës", poezi, Ferizaj, 2014)



Shkruan: Qëndrim MORINA

Duke lexuar vëllimin me poezi "Hiri i fjalës", të autorit Ragip Sylajt, njihemi me një zhanër estetik i cili nuk është i pashkëputshëm nga ligjësitë e tij. Poezitë e Ragipit kanë shumë estetikë sepse, ndërmjet kodit poetik që ka brenda vetes, i aktualizon disa tema dhe probleme, sa karakteristike, po aq edhe interesante për fushën e mendimit teorik, kritik dhe letrar.

Libri "Hiri i fjalës" në vitin 2014 fitoi çmimin e parë në konkursin letrar të Klubit Letrar "De Rada" në Ferizaj. Libri është i ndarë në katër njësi të mëdha. Njësia e parë titullohet "Iluminim" dhe përmban poezitë: "Si shkruhet libri i pamundësisë", "Arketip bukurie", "Si të shkoj në veri",

"Uria e lirisë", "Përhitje" dhe "Bisedë me demonin".

Njësia e dytë titullohet "Fundi i ankthit" dhe përmban këto poezi: "Këngë të ankthshme" dhe "Letrat" (Letër babës, Letër nanës, Letër vëllait-Bujarit, Letër A-së, Letër një miku në Preshevë, Letër një miku në Grac).

Njësia e tretë titullohet "Pëlcitje zbrazëtie" dhe përmban këto poezi: "Kopshti zoologjik (kali, lopa, viçi, gomari, dragoi, ujku, qeni, peshku, delja, derri) dhe "Absurd i përkryer" (dashuria, zhgënjimi, absurdi, vdekja, minotauri).

Njësia e katërt titullohet "Kryehimn" dhe përmban këto poezi: "Ishullimi", "Kërkim", "Luli i madh", "Mjeshtri i kurtheve", "Lotoi ylli im", "Zdrukthëtarët", "Shndërrim", "Alegro", "Madrigal", "Kryehimn për gruan" dhe "Në kërkim të vetes".

Poezia hyrëse, "Letër emnakut", kap njërën ndër çështjet më të rëndësishme të personalitetit të poetit, por edhe të njeriut në përgjithësi, gjakimin e pareshtur të njeriut që ta njohë të panjohurën, te vetja dhe te tjetri. Kjo është një-

farë dore edhe rruga e zhvillimit të mendjes njerëzore. Poeti në këtë poezi gjithmonë është i mendimit se njeriu formohet edhe si ndikim i tjetrit, pra "tjetri" ka shumë rëndësi për krijimin e botës dhe gjithçka që lidhet me të. Këtë më së miri autori na e jep në poezinë e parë, në rreshtat e parë, në faqe 7:

Merre me mend të ecja gjurmëve tua

Do të isha më afër plakjes

Të ecje udhëve të mia

Do të ishe më afër përflakjes

Të ishe brenda lëkurës sime
S'di sa do ta doje veten, (fq. 7).

Titulli i poezisë "Si të shkruhet libri i pamundësisë" paraqet një lloj metafore nëpërmjet së cilës autori shënon pamundësinë e lidhjes me botën dhe komunikimit me të.

Simbolizimi i ambientit, kryesisht i ambientit familjar, që lidhet ngushtë me fëmijërinë dhe zhvillimin e poetit, të lëmbresa të forta në vetëdije, pastaj i pjesëve të ndryshme të ligjëratës, është një përpyetje

që cikli të çohet në një sistem shenjash të cilat janë të lidhura organikisht. Poeti "Letrat" i ka të llojeve të ndryshme, varësisht prej gjendjes emocionale. Pra, vetmia, malli, vendlindja janë baza emocionale mbi të cilën janë shkruar këto poezi. Në ciklin "Pëlcitje zbrazëtie" autori na jep disa poezi ndërmjet krijimeve të këtij lloji, "Kopshti zoologjik" dhe "Absurd i përkryer". Ai na tregon në mënyrë paradoksale se ndërmjet këtyre dy tablove ndërtohet ekzistenca njerëzore. Poezitë e ciklit "Kopshti zoologjik" (kali, lopa, viçi, dragoi, gomari, ujku, derri, qeni, delja, peshku) strukturohen mbi problemet, dilemat dhe kundërthëniet. Me një fjalë, mbi fatin e ekzistencës njerëzore. Kështu, në poezinë "Kali" shtrohet kundërthënia ndërmjet realitetit objektiv dhe realitetit fiktiv, ndërmjet reales dhe ideale. Ja:

Më kali se kali është ai kali që s'di të sillet si kali
Dhe që e bart nofken e budalait (f. 49).

Përveç kësaj, autori në ciklin

"Absurd i përkryer" na jep temat të cilat mjaft mirë i ka lëvruar, si: dashuria, zhgënjimi, absurdi, durimi, vdekja, minotauri. Kështu pra, ai ka dhënë kontraste, respektivisht kundërvënie për krijimin e botës me të dhe module të kësaj natyre.

Dhe, njësia e katërt "Kryehimn" përmban disa poezi që janë shumë interesante për mënyrën se si janë krijuar, shembull: "Mjeshtri i kurtheve". Pra, mund të përfundoj se libri me poezi "Hiri i fjalës, qoftë me zgjedhjen e tematikës, pra me sistemin e saj përmbajtjesor, qoftë me realizimin e saj artistik a sistemin e tij shprehës, besoj se ka dhënë një shkallë të lartë receptimi për publikun tonë lexues.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri

Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CHILE - HONDURAS

1

BRISTOL ROVERS - BARNET

1

SHAKHTYOR SOL. - BATE BORISOV

1

Feston Kosova

Kosova ka arritur sukses historik me kualifikimin në "play-off" të Ligës së Kombeve, pasi përfundoi e para në grupin 3 të Ligës D. "Dardanët" të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" e 'shkelën' skuadrën përfaqësuese të Azerbajxhanit, në ndeshjen ku shkëlqej Arbër Zeneli me tre gola, derisa në portë debutoi portieri i Manchester Cityt, Arjent Muriqi. Festa në stadium, por edhe në kryeqytet, vazhdoi me orë të tëra, derisa kundërshtarë e Kosovës në 'play-off' është Maqedonia

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e fitoi bindshëm ndeshjen ndaj Azerbajxhanit me rezultat 4-0, dhe në këtë mënyrë u kualifikua në Ligën C. Më meritori për këtë fitore ishte Arbër Zeneli, i cili realizoi tre gola, kurse një tjetër e shtoi Amir Rrahmani. "Po ma 'donë' në Prishtinë. Falënderoj ekipin për topat e jashtëzakonshëm. Na shkoi shumë mirë. Luftuam shumë si ekip. Patëm gjithë vëmendjen për të fituar këtë ndeshje dhe jemi një nga katër ekipet në 'play-off", ka thënë Arbër Zeneli. Pavarësisht se Kosovës i mjaftonte edhe barazimi për të arritur kualifikimin tutje, futbolistët "Dardanët" e nisën fuqishëm ndeshjen dhe shënuan pas dy minutave lojë, autor i golit ishte Arbër Zeneli. Pas golit të shënuar dhe përkrahjes se pandërprerë të shikuesve, Kosova e vazhdoi dominimin në pjesën e parë, por pa arritur të shënojë golin e dytë. Në anën

tjetër mysafirët në këtë pjesë arritën vetëm një herë ta rrezikojnë portën e Kosovës, por gjuajtjen e Almeidas e priti portieri Arjent Muriqi. Ky i fundit e zhvilloi lojën e parë si titullar në Përfaqësuesen e Kosovës. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 1-0, kurse pesë minuta pasi filloi pjesa e dytë Arbër Zeneli shënon edhe golin e dytë për vendasit. Përkrahja për ekipin përfaqësues nga shikuesit që e kishin stërmbytur stadiumin "Fadil Vokrri" vazhdonte të ishte në nivel të lartë. Tetë minuta pas golit të dytë, Rashica krosin bukur për Muriqin që nuk e arriti topin, derisa nga topi i devijuar përfiton Shala që godet nga distanca, por pa ndonjë rrezik për portierin mysafir. Në minutën e 61-të Kolloi krosin nga një ndërprerje derisa në zonën e rreptësisë për mrekulli gjendet mbrojtësi Amir Rrahmani që realizon me kokë për 3-0. Pesë minuta më vonë mysafirët e regjistruan edhe rastin e dytë për shënim, por gjuajtjen e Mirabdulla Abbasovit e ndali portieri Muriqi. Në minutën e 76



KOSOVA - AZERBAJXHANI 4-0

Gjyqtarë: Beniot Millot, Mehdi Rahmouni, Bertrand Jounaud.
Kartonë të verdhë: Fidan Aliti (Kosova), Dimitrij Nazarov, Araz Abdullayev, Tamkin Khalilzade.
Kosova: Muriqi, Vojvoda, Rrahmani, Aliti, Kolloli, Shala, Kryeziu, Rashica (Zhegrova), Berisha (Halimi), Zeneli, Muriqi (Nuhui).
Azerbajxhani: Agayev, Garayev, Pashayev, Medvedev, Huseynov, Abdullaayev (Gurbanov), Nazarov, Dadosov (Ismayilov), Madatov (Abassov), Almedia, Khalilzade.

Arbër Zeneli e komplettoi tregolshënin në këtë ndeshje, kurse zëvendësuesi pak minuta më vonë, Edon Zhegrova, e shërbeu mirë Atdhe Nuhin, por ky i fundit nuk arriti të realizojë. Kolloli

rrezikoi dy herë të tjera, por pa sukses dhe rezultati përfundimtar i ndeshjes ishte 4-0. Festa në stadiumin "Fadil Vokrri" pas përfundimit të ndeshjes ishte e jashtëzakonshme, kurse pak

minuta pas përfundimit të ndeshjes festa vazhdoi edhe nëpër qytet për disa orë. Pas gjashtë ndeshjeve të zhvilluara Kosova ka grumbulluar gjashtë pikë dhe kualifikohet e para e grupit në Ligën C, kurse Azerbajxhani përfundoi i dyti me 9 pikë. Ishujt Faroe renditen në pozitën e tretë me 5 pikë, kurse Malta është e fundit me 3 pikë. Pas ndeshjes, trajneri Bernard Challandes ka deklaruar: "Ishte e mrekullueshme që realizuam menjëherë. Ishte më e rëndësishmja që skuadra ishte e gatshme për luftë që nga fillimi. Është e mrekullueshme sepse mund të fitojmë. Të fitojmë dy ndeshje për Kampionatin Evropian. Është e mahnitshme. Tani kemi kualifikimet e tjera, por në kokë gjysmëfinalja dhe pas saj ndoshta finalja. Është mirë për motivimin e lojtarëve".

SHQIPËRIA E FITOI MIQËSOREN NDAJ UELLSIT

Shqipëria ka arritur të fitojë 1-0 miqësoren ndaj Uellsit, falë një penalltie të shndërruar në gol nga Bekim Balaj në pjesën e dytë. 11-metërshi i ekzekutuar nga sulmuesi shkodran u fitua në minutën e 58 nga Taulant Xhaka. Në pjesën e parë ishte portieri Berisha ai që shpëtoi Shqipërinë në dy raste, ndërkohë që pas golit të kombëtares sonë, uellsianët patën pretendim për penallti në dy raste.

Mulaomeroviq publikoi listën e Kosovës për ndeshjen me Rumaninë dhe Maqedoninë

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Përzgjedhësi i Kosovës në basketboll, Damir Mulaomeroviq, e ka publikuar listën e gjerë të Përfaqësueses A, e cila më 29 nëntor dhe 2 dhjetor do t'i zhvillojë ndeshjet në kuadër të Grupit B të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Kosova më 29 nëntor do të përballet me Rumaninë në qytetin Oradea, kurse më 2 dhjetor në Gjevgjeli do të ballafaqohet me Maqedoninë. Kosova më 13 shtator në shtëpi të vet është mposhtur nga Maqedonia me rezultat 76:73, derisa kjo e fundit

ka triumfuar edhe ndaj Rumanisë me shifrat 90:76 dhe kështu i prin Grupit B. Kosova në ndeshjen e fundit në kuadër të kësaj faze parakualifikuese do të përballet me Rumaninë në Prishtinë më 24 shkurt 2019. Fituesi i këtij grupi do të kualifikohet në kualifikime për Eurobasket 2021 që do të fillojë në nëntor të vitit të ardhshëm, kurse dy kombëtares e tjera e kanë edhe një shans tjetër për t'u kualifikuar, por nëpërmjet një raundi shtesë që do të luhet në gusht të vitit 2019. Emër i ri në përfaqësuesen e Kosovës është



basketbollisti i natyralizuar, amerikan Malcom Armstead, i cili luan në pozitën e plejmejkerit dhe i cili pritet ta ndihmojë dukshëm ekipin e Kosovës në këto ndeshje mjaft të rëndësishme për përfaqësuesen tonë. Armstead, 29-vjeçar (1.83 m),

aktualisht është lojtar i skuadrës Buyukçekmece, anëtare e Superligës së Turqisë. Ai më parë ka luajtur edhe për Krka (Slloveni), Avtodor Saratov (Rusi), AEK Athens (Greqi), Istanbul BB (Turqi), Yeşilgiresun Belediye (Turqi), Neptūnas (Lituanë) dhe Rethymno Cretan Kings (Greqi). Duhet theksuar se Përfaqësuesja A më 24 nëntor do të udhëtojë për në Debrecen të Hungarisë, ku do të qëndrojë deri më 28 nëntor në përgatitje të përbashkëta, më pas do të niset për në Oradea për t'u ballafaquar një ditë më vonë me Rumaninë, derisa pas ndesh-

LISTA E BASKETBOLLISTËVE

1. Dardan Berisha
2. Fisnik Rugova
3. Lis Shoshi
4. Gëzim Morina
5. Meriton Ismaili
6. Ergin Grosha
7. Leonard Mekaj
8. Valon Bunjaku
9. Andi Shehu
10. Rron Ukaj
11. Altin Morina
12. Mikaile Tmusiq
13. Muhamedali Janjeva
14. Malcom Armstead

jes me rumunët do të niset për në Gjevgjeli për t'u përballur me Maqedoninë më 2 dhjetor.

Klitschko pritet të rikthehet në ring, kundërshtar Joshua

MOSKË, 20 NËNTOR - Vazhdimisht po shtohen zërat për një rikthim të mundshëm të boksierit ukrainas Wladimir Klitschko në ring që duket se është gati ta zhvillojë revanshin me kampionin e botës në peshën e rëndë Anthony Joshua. Por ish-menaxheri i Klitschkos, Bernd Boente, ka

thënë se ukrainasi nuk ka për t'u rikthyer në ring, deklarata që duket se është hedhur poshtë nga vetë ish-kampioni i botës. Wladimir Klitschko në një mesazh në rrjetet sociale shkruan: "Që kur jam tërhequr nga sporti, unë dhe vëllai im kemi qenë aktivë në fusha të ndryshme të jetës.

Por asnjëri nga ne nuk ka nevojë për një menaxher personal". Joshua e Klitschko kanë dueluar në prill të 2017-s, në "Wembley", me britanikun që fitoi me "KO teknik" sfidën e parë, ndërkohë që kjo ishte sfida e fundit e ukrainasit, që më pas u tërhoq nga sporti.



Ronaldo: Ndeshjen ndaj Unitedit nuk e harroj kurrë

SAO PAOLO 20 NËNTOR - Ish-sulmuesi i Brazilit, Ronaldo, vazhdon të mbetet një nga futbollistët më të mëdhenj të historisë së futbollit. Pa lëndimet që e përcollën gjatë gjithë kohës, ai mund të bëhej absolutisht më i miri i të mirëve. Tashmë Ronaldo e mban rolin e presidentit të Valladolidit në elitën e futbollit spanjoll, ndërsa në një prononcim për "Sky Sport", Ronaldo i rikthehet një prej momenteve më të bukura të karrierës së vet. Ishte 23 prilli i vitit 2003 dhe në "Old Trafford" luhej ndeshja e Ligës së Kampioneve në mes të Manchester Unitedit dhe Real Madridit. Ishte ndeshja e kthimit të çerekfinaleve. Ronaldo shënonte një tregolësh fantastik, ndërsa skuadra e Fergusonit fitonte me rezultatin 4-3. Në gjysmëfinale kalonin madrilenët, në sajë të fitores 3-1 në ndeshjen e parë, ndërsa Ronaldo nuk e harron kurrë atë natë. "Të luash për Realin e Madridit është ëndrra e të gjithëve, është maksimumi. Njësoj si ta veshësh bluzën e Brazilit. Më kujtohet një nga momentet më të rëndësishme të jetës sime. Një ndeshje e Ligës së Kampioneve kundër Manchester Unitedit në 'Old



Trafford'. U zhvillua një ndeshje e hapur dhe shumë e bukur, shënove 3 gola dhe ishte një spektakël i vërtetë", ka thënë Ronaldo. "Gjëja më e bukur ndodhi kur u zëvendësua: tifozët më dhuruan një 'standing-ovation'. Nuk e prisja, por të gjithë njerëzit ishin ngritur në

këmbë për mua. U befasova nga reagimi spontan i kundërshtar. Ishte një moment magjik, një nga më të rëndësishmit në jetën time. Futbolli është gjithçka dhe kur rikthehem pas në kohë, ndihem krenar për çfarë kam bërë në karrierën time", ka shtuar Ronaldo.

Charlotte mposhti Bostonin



Boston, 20 nëntor - Bostoni ka dalë kokulur nga përballja me Charlotten, pasi skuadra e Celticsit u mund 117-112 nga vendësit, ndeshje me rivalitet dhe emocione gjatë gjithë kohës, me të dyja ekipet që e kërkuan fitoren deri në fund. Kemba Walker me 43 pikë ishte vendimtar për Charlotten, duke i bërë të pavlefshme 27

pikët e 11 asistimet e Irvingut për mysafirët. Fiton skuadra e Philadelphias, që mundi 119-114 Phoenixin, sfidë me dy pamje, më e mirë për miqtë në të parën (Booker 37 pikë). Në pjesën e dytë u dalluan vendësit, me Embiidin që realizoi 37 pikë e 17 rebounde. Moment i mirë për ekipin e Clippersit në NBA, që korri suk-

sesin e pestë radhazi, me kalifornianët që mundën 127-119 Atlantën në fushën e kësaj të fundit. Young realizoi 25 pikë e 12 asistime për vendësit, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Clippersat u dallua dyshja Harrell-Harris, që së bashku realizuan 49 pikë. Moment i mirë për Milwaukee, që mundi 104-98 Denverin, ndeshje me rivalitet, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Për Milwaukee u dallua Antetokounmpo me 29 pikë e 12 rebounde.

REZULTATET

Charlotte - Boston	117-112
Detroit - Cleveland	113-102
Indiana - Utah Jazz	121-94
Philadelphia - Phoenix	119-114
Atlanta - Clippers	119-127
Memphis - Dallas	98-88
Milwaukee - Denver	104-98
New Orleans - San Antonio	140-126
Sacramento - Oklahoma	117-113

SHKURT

Ajaxi, PSV-ja dhe Fenerbahçe e kërkojnë Zenelin

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, është në "radar" të skuadrës turke Fenerbahçe. "Arbër Zeneli është preferencë e Fenerbahçes për afatin kalimtar të janarit. Zeneli ka dëshmuar veten në Holandë. Fenerbahçe duhet ta bindë mesfushorin, pasi në garë janë edhe Ajaxi dhe PSV-ja", shkruan "fanatik.com.tr". Futbollisti 23-vjeçar këtë edicion në elitën e futbollit holandez ka shënuar dy gola në 12 paraqitje dhe ka dhënë shtatë asistime. Sipas "transfermarkt.de", vlera e kartonit të Zenelit është pesë milionë euro.

Milani synon transferimin e këtyre yjeve në janar

AC Milan ka një krizë me lëndimet e lojtarëve, kurse Leonardo është duke punuar intensivisht për transferimin e disa lojtarëve në janar. I pari në listë është mesfushori i Chelseat, Cesc Fabregas, që edhe në të kaluarën ka qenë në shënjestër të Milanit, kurse pas tij gjenden edhe Zlatan Ibrahimović dhe mesfushori i Barcelonës, Arturo Vidal. Ibra pritët të rikthehet në janar, ku do të firmosë për gjashtë muaj me një rrogë prej dy milionë eurosh.

Koulibaly: Juve ka frikë nga Napoli

Mbrojtësi Kalidou Koulibaly është i bindur se Juventusit frikësohej nga Napoli sezonin e kaluar dhe thotë se ende ëndërron t'ua shpaguajë me një titull kampioni në Serinë A dashurinë dhe besimin tifozëve të Napolit. "Vitin e kaluar besuam deri në fund sepse Juventusit frikësohej nga ne dhe kur ndien se një skuadër ta ka frikën, unë jam shumë mirë njohës dhe më pëlqen ajo ndjesi", ka thënë Koulibaly. Mbrojtësi i Senegalit është nominuar për çmimin e BBC-së për futbollistin më të mirë afrikan. "Gjëja më e rëndësishme është se unë gjithmonë përpiqem të përmirësohem, në mënyrë që t'ua dëshmojë të gjithëve se mund të jem ndër mbrojtësit më të mirë në botë", ka shtuar ai.

Sandro: Më pëlqen të luaj në Angli

Mbrojtësi i Juventusit, Alex Sandro, ka konfirmuar se dëshiron të largohet nga Juventusit. Në një intervistë për mediet braziliane ai ka treguar se do t'i pëlqente të luante një ditë në Premier Ligë. "Mendoj se një ditë do të më realizohet dëshira. Më pëlqen të luaj në Angli, por tani për tani jam i lumtur në skuadrën e Juventusit. Sot mendoj vetëm për skuadrën ku jam, ndërsa në të ardhmen nuk i dihet", ka thënë Sandro.

Seedorf: Neymari bëri gabim që u largua nga Barça

Ish-lojtari i Real Madridit, Interit dhe Milanit, Clarence Seedorf, ka komentuar largimin e Neymarit nga Barcelona vitin e kaluar. Neymar në verën e vitit 2017 për 222 milionë euro la Barcelonën për t'u transferuar te PSG-ja si lojtari më i shtrenjtë në histori. "Neymari është një talent i padiskutueshëm, por ai ka nevojë për një skuadër që e ndihmon ta japë më të mirën nga vetja. Mendoj se bëri një gabim të madh që u largua nga Barcelona aq shpejt", ka deklaruar Seedorf.

Deco zgjedh Ronaldinho para Messit dhe Ronaldos

Ish-futbollisti portugez, Deco, ka thënë se Ronaldinho është më i miri në histori. Në këtë mënyrë ish-lojtari i Barcelonës e ka vlerësuar bashkëlojtarin e dikurshëm më të mirë se Messin dhe Ronaldon. "Nëse e shikojmë nga jashtë, është e qartë se Leo dhe Cristiano janë më të mrekullueshmit, veçanërisht pasi askush nuk mendonte se ata do ta mbanin për një kohë kaq të gjatë këto cilësi. Por për mua, Ronaldinho do të jetë gjithmonë më i miri. Ne u takuam në Barcelonë dhe menjëherë krijuam një miqësi të fortë. Momentet që i përjetova me të nuk mund t'i krahasoj me asgjë tjetër, ishin magjike", ka thënë Deco.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: “Mehe Uka”- Bajgorë

Komuna: Mitrovicë

Data: 21.11.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/059 ESIP/SDG/059-G/1.1	Blerja e mjeteve te teknologjise

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles “**Mehë Uka**” **Bajgorë,Mitrovicë**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Blerja e mjeteve te teknologjise

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e “**Mehë Uka**” **Bajgorë, Mitrovicë** më së largu deri më **30 Nëntor 2018**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Bedri Musa

Telefoni: 049/922-042

E-maili: Bedrimusa2015@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: “Mehë Uka”Bajgorë

Komuna: Mitrovicë

Data: 21.11.2018

Emri i kontratës Vizitë Prizren

Numri i kontratës: ESIP/SDG/058 ESIP/SDG/059-CS/1.2

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles “**Mehë Uka**”**Bajgorë Mitrovicë**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

Vizitë Prizren

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën e shkollës “**Mehë Uka**” **Bajgorë , Mitrovicë** më së largu deri më **30 Nëntor 2018**.

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Bedri Musa**

Telefoni: **049/922-042**

E-maili: bedrimusa2015@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: “Xhevat Jusufi”- Barë

Komuna: Mitrovicë

Data: 21.11.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/062 ESIP/SDG/062-G/1.1	Blerja emjeteve te konkretizimit

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles “**Xhevat Jusufi**” **Bare,Mitrovicë**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Mjetet e konkretizimit për Kabinet të kimisë,dhe biologjisë.
- Mjetet e konkretizimit për Kabinet të fizikës,dhe ed.fizikes.
- Mjetet e konkretizimit për Kabinet të gjeografisë dhe historisë.
- Mjetet e konkretizimit për ciklin klasor

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e “**Xhevat Jusufi**” **Bare, Mitrovicë** më së largu deri më **30 Nëntor 2018**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ismajl Hjdari

Telefoni: 049132-175

E-maili: smajli70@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: “Xhevat Jusufi”Bare

Komuna: Mitrovicë

Data: 21.11.2018

Emri i kontratës Vizitë Prizren

Numri i kontratës: ESIP/SDG/062 ESIP/SDG/062-CS/1.3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles “**Xhevat Jusufi**”**Bare Mitrovicë** Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

Vizitë Prizren

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën e shkollës “**Xhevat Jusufi**”**Bare , Mitrovicë** më së largu deri më **30 Nëntor 2018**.

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:



Personi kontaktues: **Ismajl Hajdari**

Telefoni: **049/132/175**

E-maili: smajli70@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Komuna e Gjiçanit
Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nenit 4, paragrafi 1, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.4.1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-139, të Republikës së Kosovës dhe pikës VI, dhe VII të Vendimit të Kuvendit Komunal të Gjiçanit, 01.nr.16-69007 të datës 17.07.2013 Për Miratimin e Planit Rregullues Urban : " Livadhet e Arapit ", Organi Shpronësues, merr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

I. Kryetari i Komunës, APROVON - me vetëiniciativë shpronësimin e ngastrave kadastrale për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik - sigurimin e tokës për nevoja të ndërtimit të rrugëve të parapara me Planin Rregullues Urban "Livadhet e Arapit" i miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit me Vendimin 01.nr.16-69007 të datës 17.07.2013, ngastrat kadastrale, respektivisht pjesët e ngastrave kadastrale :

1. - Pjesa e ngastrës kadastrale nr.1023-1, në vendin e quajtur "Livadhet e Arapit/Kranj", pronar Valon (Bajram) Qarolli, në sipërfaqe prej 573 m², nga sipërfaqja e tërësishme prej 4393 m², me kulturë - livadh i kl 1, ZK.Gjiçan.

2. - Pjesa e ngastrës kadastrale nr.1017-0, në vendin e quajtur "Livadhet e Arapit", pronar Valon (Bajram) Qarolli, në sipërfaqe prej 2447 m², nga sipërfaqja e tërësishme prej 11476 m², me kulturë - livadh i kl 1, ZK.Gjiçan.

3. - Pjesa e ngastrës kadastrale nr.1148-0, në vendin e quajtur "Livadhet e Arapit", pronar Afrim Qarolli, në sipërfaqe prej 463 m², nga sipërfaqja e tërësishme prej 2554 m², me kulturë - livadh i kl 1, ZK.Gjiçan.

4. - Pjesa e ngastrës kadastrale nr.1160-1, në vendin e quajtur "Livadhet e Arapit", pronar Jahi (Hajdin) Zeqiri, në sipërfaqe prej 199 m², nga sipërfaqja e tërësishme prej 407 m², me kulturë - livadh i kl 1, ZK.Gjiçan.

5.- Ngastra kadastrale nr.1160-4, në vendin e quajtur "Livadhet e Arapit", pronar Jahi (Hajdin) Zeqiri, në sipërfaqe prej 75 m², nga sipërfaqja e tërësishme prej 75 m², me kulturë - rrugë, ZK.Gjiçan.

II. VËRTETOHET se është qëllim i ligjshëm publik dhe i domosdoshëm - sigurimi i tokës për ndërtimin e rrugëve të parapara sipas Planit Rregullues Urban "Livadhet e Arapit", dhe shpronësimi është në fuksion të arritjes së këtij qëllimi të ligjshëm publik.

III. Vendimin Preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t'ia dërgon pronarëve, zotëruesit të interesit të pronës dhe personave tjerë që pretendojnë se i takon një e drejtë në pronën e shpronësuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi brenda 10 ditëve pas miratimit dhe në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madhë në Kosovë .

Arsyetim

Kryetari i Komunës me vetëiniciativë, ka kërkuar iniciimin e procedurës së shpronësimit në lidhje me shpronësimin e pronave të paluajtshme në ngastrat kadastrale me të dhënat e përshkruara si në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi Preliminar e me qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm publik- sigurimit të tokës për ndërtimin e rrugëve të parapara sipas Planit Rregullues Urban "Livadhet e Arapit".

Kryetari i Komunës kësaj kërkesë ia ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili parashihet me dispozitën e nenit 8 lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr.03/L-139 të Republikës së Kosovës, pasi në këtë rast shpronësimi është njëri nga qëllimet e ligjshme publike në lokacionin e përmendur më lartë, se ky shpronësim është në fuksion të zbatimit të Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjiçanit të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal, 01.Nr.16-69007 të datës 17.07.2013, për Miratimin e Planit Rregullues Urban "Livadhet e Arapit". Ky shpronësim, në mënyrë të qartë dhe të drejtëpërdrejtë është i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të cekur më lartë, shpronësimi në fjalë prek të drejtat private. Pjesët e pronave të paluajtshme si objekt shpronësimi nuk janë zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues, dhe Organi shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji. Ky qëllim nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit të këtyre pjesëve të ngastrave kadastrale dhe përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat ndikohen negativisht nga shpronësimi.

Organi Shpronësues në pajtim me paragrafin 4 të nenit 10 të këtij Ligji, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi shpall Vendim Preliminar në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madhë në Kosovë .

Vendimin Preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, Organi shpronësues, do t'ia dërgon pronarëve, zotëruesve të interesit të pronës dhe personave tjerë që pretendojnë se u takon një e drejtë në pjesën e pronave të shpronësuar në pajtim me nenin 10 paragrafi 3 të këtij ligji.

Udhëzim për mjetin juridik : Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së padisë në Gjykatën Komunale në Gjiçan brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi e nëpërmjet Organit Shpronësues - Kryetarit të Komunës së Gjiçanit.

Vendimi u dërgohet : pronarëve juridik - faktik, Gazetës Zyrtare të Kosovës dhe Arkivit.

Organi Shpronësues
Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri
Lutfi Haziri

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mexhit Bajrami nga Shtimja, shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Naim Frashëri" Shtime.

► Islam Kajmakçi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

► Adelina Buzhala shpall të pavlefshme dëftesat e vitit I, II SHMM "Luciano Motroni" Suharekë

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronarët që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m². Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

NPT AGROKOVRAKA-FRUT


SHPALL TENDER PER NDERTIMIN E DEPOS

1 .PLLAKA DHE IZOLIMET E PLLAKES
2. KONSTRUKSIONI I QELIKUT ME PANEL
FRIGO

NUMRI KONTAKTUS 044140588 Kovragë -Istog
n-azi.b@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

Opština Gnjilane Predsednik opštine

Na osnovu clana 10, stav 1, clan 4, stav 1, stav 2, podstav 4.4.1 Zakona o eksproprijaciji nepokretne imovine br.03/L-139 Republike Kosova i tacke VI,i VII odluke Skupštine Opštine Gnjilane, 01.br.16-69007 datuma 17.07.2013.god, za usvajanje Urbanog Regulativnog Plana: "Livadhet e Arapit", eksproprijacioni organ, donosi ovu:

PRELIMINARNU ODLUKU

I.Predsednik opštine, ODOBRAVA – samoinicijativno eksproprijaciju katastarskih parcela za dostizanje javnog zakonskog cilja-osiguranje zemljišta za potrebe izgradnje puteva predvidjenih Urbanim regulativnim planom "Livadhet e Arapit" usvojen od strane SO Gnjilane sa odlukom 01.br.16-69007 datuma 17.07.2013.god, katastarske parcele odnosno delove delove katastarskih parcela:

- 1.- Deo katastarske parcele br.1023-1 na mestu zvanom "Livadhet e Arapit/Kranj", vlasnik Valon (Bajram) Qaroli, površine 573 m², od ukupne površine 4393 m², kultura-livada prve klase, ZK Gnjilane.
- 2.- Deo katastarske parcele br.1017-0 na mestu zvanom "Livadhet e Arapit", vlasnik Valon (Bajram) Qaroli, površine 247 m² od ukupne površine 11476 m², kultura-livada prve klase KZ Gnjilane.
- 3.-Deo katastarske parcele br.1148-0 na mestu zvanom "Livadhet e Arapit", vlasnik Afrim Qarolli, površine 463 m², od ukupne površine od 2554 m², kultura-livada prve klase, KZ Gnjilane.
- 4.- Deo katastarske parcele br.1160-1, na mestu zvanom "Livadhet e Arapit", vlasnik Jahi (Hajdin) Zeqiri, površine 199 m², od ukupne površine od 407 m², kultura livada prve klase, KZ Gnjilane.
- 5.- Katastarska parcela br.1160-4 na mestu zvano "Livadhet e Arapit", vlasnik Jahi (Hajdin) Zeqiri, površine 75 m² od ukupne površine od 75 m², kultura-put KZ Gnjilane.

II.POTVRDUJE SE da je javni zakonski cilj neophodan-osiguranje zemljišta za izgradnju puteva predvidjenih Urbanim regulativnim planom "Livadhet e Arapit", i eksproprijacija je u funkciji dostizanja ovog zakonskog javnog cilja.

III. Preliminarnu odluku u toku 5 (pet) radnih dana nakon usvajanja, eksproprijacioni organ poslaca vlasnicima imovine i drugim osobama koje potenciraju da imaju pravo na eksproprijacionu imovinu.

IV.Ova odluka stupa na snagu 10 dana nakon usvajanja i od datuma objavljivanja u Sluzbenom listu Kosova i u novinama najveceg tiraža na Kosovu.

Obrazloženje

Predsednik opštine samoinicijativno trazio je iniciranje postupka eksproprijacije u vezi sa eksproprijacijom nepokretne imovine u katastarskim parcelama sa podacima opisanim kao u tacki 1 klauzule ove preliminarne odluke sa dostizanjem javnog zakonskog cilja-osiguranje zemljišta za izgradnju puteva predvidjenih Urbanim regulativnim planom "Livadhet e Arapit".

Predsednik opštine ovom zahtevu priložio je svu potrebnu dokumentaciju koja je previdjena odredbama clana 8 vezanih sa clanom 4 Zakona za eksproprijaciju nepokretne imovine br.03/L-139 Republike Kosova, jer je u ovom slucaju eksproprijacija jedan od javnih zakonskih ciljeva na gore pomenutoj lokaciji, i ova eksproprijacija je u funkciji izvršenja Urbanog razvojnog plana grada Gnjilane usvojena odlukom Skupštine Opštine 01.br.16-69007 datuma 17.07.2013.god, za usvajanje Regulativnog urbanog plana "Livadhet e Arapit". Ova eksproprijacija na jasan i direktan nacin je neophodna za postizanje gore navedenog cilja, i eksproprijacija utice na privatna prava.

Delovi nepokretne imovine kao objekat eksproprijacije nisu odabrane za dostizanje jednog cilja ili diskriminacione svrhe i eksproprijacioni organ ispunio je sve primenjive odredbe ovog zakona. Ovaj cilj ne moze se dostici na praktican nacin bez izvršenja eksproprijacije ovih delova katastarskih parcela i javne koristi od eksproprijacije su vece od interesa koji negativno uticu na eksproprijaciju.

Eksproprijacioni organ u saglasnosti sa stavom 4, clana 10 ovog zakona, u roku od 10 (deset) dana posle usvajanja ove odluke objavljuje preliminaru odluku u Sluzbenom listu Kosova i u novinama sa najvecim tirazom na Kosovu.

Preliminarnu odluku u roku 5 (pet) radnih dana nakon usvajanja, eksproprijacioni organ poslat ce vlasnicima imovine i drugim osobama koji misle da imaju pravo na delove eksproprijacione imovine u skladu sa clanom 10, stav 3 ovog zakona.

Pravna pouka: protiv ove odluke nezadovoljna stranka ima pravo žalbe u Opštinskom sudu u Gnjilanu, u roku od 30 dana nakon stupanja na snagu ove odluke preko eksproprijacionog organa-Predsednik opštine Gnjilane.

Odluka se salje: pravnim vlasnicima-faktickim, Sluzbenom listu Kosova i Arhivi.

Eksproprijacioni organ
Predsednik opštine
Lutfi Haziri
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.536/17

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Malsor Kryeziu, me sekretaren juridike të kësaj Gjykate Drita Haxhishabani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Zef Kola nga fshati Bec Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, kundër të paditurve: 1.Pren (Lush) Uka, nga fshati Bec Komuna e Gjakovës, 2. Ukë (Lush) Uka, nga fshati Bec Komuna e Gjakovës, 3. Nikollë (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë, 4.Vuksan (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë, të paditurit 3 dhe 4 tani me adresë të panjohur jashtë shtetit, me objekt të kontestit për kthim në posedim, duke vendosur lidhur me propozimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit 3 dhe 4, me date 14.09.2018, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Të paditurve Nikollë (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë dhe Vuksan (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë, tani me adresë të pa njohur jashtë shtetit, të cilëve tani nuk iu dihet adresa e saktë, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokati Prek Kola, nga Gjakova.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetatat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësi Zef Kola nga fshati Bec Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me objektin e kontestit për kthim në posedim, kundër të paditurve 1.Pren (Lush) Uka, nga fshati Bec Komuna e Gjakovës, 2. Ukë (Lush) Uka, nga fshati Bec Komuna e Gjakovës, 3. Nikollë (Marash) Shabanaj dhe 4.Vuksan (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë, tani me adresë të pa njohur.

Gjyqtari gjykues pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se nga fletë dërgesat për dorëzim personal se të paditurit 3. Nikollë (Marash) Shabanaj dhe 4.Vuksan (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë, gjendet me familje jashtë shtetit, mirëpo pa e specifikuar adresën dhe se nuk dihet ku janë vendosur, gjegjësisht se ku jetojnë.

Gjykata ka nxjerrë aktvendim C.nr.536/17, të dt.02.03.2018, me të cilin e ka ftuar palën paditëse që në afat prej 3 ditësh të bëjë precizimin e adresës për të paditurit 3 dhe 4 dhe gjykatës ti paraqet adresën e saktë për të paditurit.

Paditësi me parashtrësën e dt.15.03.2018, e njofton gjykatën se paditësi nuk posedon adresë tjetër përveç adresës e cila gjendet në shkresat e lëndës për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që në mungesë të adresës për të paditurit 3 dhe 4 të njëjtve ti caktohet një përfaqësuesi i përkohshëm në bazë të nenit 79 të LPK-ës.

Gjyqtari pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke pasur parasysh se procedura për caktimin e përfaqësuesit ligjor do të zgjatë shumë, e në anën tjetër do të shkaktohen dëme të pa nevojshme palës paditëse e me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme gjykata i caktoj avokatin Prek Kola nga Gjakova-përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurit Nikollë (Marash) Shabanaj dhe Vuksan (Marash) Shabanaj, nga Lagja Piskotë, nr.39, Gjakovë, tani me adresë të pa njohur, gjersa ai apo i autorizuari i tyre të paraqitet në këtë gjykatë apo gjersa organi i kujdestarisë të njoftojë se ka caktuar kujdestarin.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimin konfrom dispozitive të nenit 79.3 pika a) dhe b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Nr.03/L-006, 30 qershor 2008.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.536/17 të datës 14.09.2018



U bënë 7 vite pa më të dashurin tonë

TAHIR KAJTAZI

(03.02.1932 - 21.11.2018)

Kur të përmendi fjalën baba shpirti me dhemb,
kur shkruajmë përkujtim për ty baba i dashur,
është dhimbje e madhe.

As fjalët, as dhembja, as koha, nuk e shërojnë
mallin për ty.

Kaluan 7 vite pa ta dëgjuar zërin tënd të ëmbël
qe e kishe.

Na është tharë goja pa e thirr emrin më të dashur
që ekziston në këtë jetë, fjalën babe.

Të jetojmë pa ty qenka shumë e vështirë, jeta po
vazhdojka por malli për ty nuk shuhet kurrë

Baba.

E përkujtojnë më shumë mall e dashuri:

*bashkëshortja Fatimja, vajzat Myrvetja, dhëndëri
Enveri, vëllai Ajeti dhe gjithë familja Kajtazi nga
Tërnova e Skenderaj.*



Lagja Ulpiana | Rr. Zija Shemsu | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

Data: 21.11.2018
Vendi: Prishtinë, Kosovë
Ref: 0061-11-18
Nga: IPKO Telecommunications LLC

Titulli: Ftesë për ofertim – Këmisha (Uniforma) për stafin e IPKO-s

Të nderuar,

IPKO Telecommunications fton të interesuarit për ofertim konkures, për Këmisha (Uniforma) për stafin e IPKO-s.

Dokumentacioni me kushtet e përgjithshme për ofertim mund të tërhiqet më **21, 22 dhe 23.11.2018** në zyrën e IPKO-s në Rr. Zija Shemsu nr.34, Ulpianë – Prishtinë.
Mostra e IPKO-s do të ju prezantohet të interesuarve me rastin e tërheqjes së dokumentacionit me kushtet e përgjithshme, në adresën e lertëcekur.

Në rast të interesimit, ju mund ta dërgoni ofertën tuaj në adresën e lertëcekur, jo më vonë se **27.11.2018, ora 15:00h**. Oferta dhe mostrat duhet të jenë të futura në zarf/ambalazh dhe të shënohen qartë me titullin e qëllimit.

Sinqerisht

IPKO Telecommunications
Ulpianë, Rr. Zija Shemsu nr.34
10000 Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Financave- Ministarstvo za Finansija- Ministry of Finance

Ministria e Financave zgjatë:

VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Vazhdohet për 7 ditë kalendarike afati i konkursit të shpallur nga data 06/11/2018 deri më datë 20/11/2018, për pozitën e lirë:

- Zhvillues dhe Administrator i lartë i sistemeve softverike (3 pozita), nr. Referencës 22/2018/DIT/MF;

Afati i konkurimit vazhdohet nga data 21. nëntor 2018 deri më datën 27. nëntor 2018 deri në orën 16.00.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Sheshi Nënë Tereza p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjëni edhe në web-faqen <https://mf.rks-gov.net/>
Kërkesat për punësim dorëzohen në zyrën e burimeve njerëzore nr. N-1207 kati XII, ndërtesa e Qeverisë, ose përmes postës.

Për informata shtesë mund të njohoheni përmes telefonit 038-200-34.155 dhe 038-200-34-196

Ministarstvo za finansije:

PRODUŽAVA ROK KONKURSA

Produžava se za 7 kalendarskih dana rok konkursa objavljenog od 06/11/2018 do 20/11/2018, za slobodnu poziciju;

- Razvijatelj i viši administrator softverskih sistema (3 pozita), br. Referencije - 22/2018/OIT/MF;

Produžava se rok za konkurisanje od 21. novembra 2018 do 27. novembra 2018 do 16.00 časova.

Zahtevi za zapošljavanje i opis poslavlja mogu se dobiti na recepciji zgrade vlade Republike Kosova (ulica Majka Tereza bb). Obrazce za apliciranje možete preuzeti i sa veb-sajta <https://mf.rks-gov.net/>
Zahtevi za zapošljavanje predaju se u kancelariji ljudskih resursa br. N-1207 XII sprat, Zgarda Vlade, ili poštom.

Dodatne informacije možete dobiti preko telefona: 038-200-34-155 i 038-200-34-196.



Republika e Kosoves
Republika Kosova –Republic of Kosovo
Komuna Dragash- Opština Dragaš-Dragas Municipality

Në bazë të nenit 11,12 par.1 pika 1.1 të ligjit nr.03/L-149 për Sherbimin Civil të Kosovës, neni 3 dhe 4 të Rregullores nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Sherbimin Civil, Sherbimi i Personelit-Dragash shpall këtë:

K O N K U R S

Nr.03.111/01-27550
Titulli i Punës: Inspektor i Veterinës
Njësia: Shërbimi i Inspeksionit
Departamenti: Drejtoria për Bujqësi ,Pylltari, Zhvillim Rural Turizëm dhe Inspeksion
Niveli i pages, Koeficienti: 7 (Grada 8)
Kontrata: 1 (një) vjeçare (Me mundesi vazhdimi)
Orari i punës: Me orar të plotë (40 orë në javë)
I raporton: Shefit të shërbimit të inspeksionit, dhe drejtorit
Qëllimi i vendit të punës : Promovimi ,monitorimi ,inspektimi i sistemit të kontrollit veterinar ,duke u bazuar në legjislacionin ne fuqi.

Detyrat dhe Përgjegjësit;

- Bën inspektimin e mishit dhe organeve të brendshme të kafshëve të cilat janë të dedikuara për konsum publik;
- Bën damkosjen e mishit, me çka vërtetohet se i njëjti është kontrolluar dhe vërtetuar dhe se i përgjigjet normave të parapara me ligj për konsum të sigurt publik;
- Kontrollon dhe monitoron kushtet e prodhimit dhe përpunimit që kanë të bëjnë me parrezikshmërinë e ushqimit me prejardhje shtazore për konsum publik;
- Kontrollon thertoret, fabrikat e përpunimit të mishit, qumështore, mishtoret si dhe kontrollin e ushqimit të kafshëve;
- Bënë kontrollin e lëndëve të para dhe aditivëve të cilat përdoren në prodhim dhe në përgatitje të ushqimit, kontrollit të përmbajtjes së ushqimit;
- Marrjen e mostrave,në rast dyshimi dhe dërgimin e tyre në laborator;
- Mbikëqyrja e praktikave private veterinarë dhe teknikëve të veterinarisë, me qëllim të marrjes së masave të çrrënjësjes së sëmundjeve ngjitëse;
- Parandalimi ,dhe ndermarrja e masave për luftimin e sëmundjeve infektive të kafshëve;
- Kontrollon sigurinë e ushqimit me prejardhje shtazore,kontrollon qarkullimin e mbeturinave me origjinë shtazore;
- Ushtron fletëparaqitje për shkelje të dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtje;

Kualifikimi arsimor dhe shkathtësitë kryesore të kërkuara

- Diplomë universitare, drejtimet veterinarë 3 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e inspektimit në lëmin e veterinarisë ;
- Shkathësi në komunikim planifikim dhe punë në ekip;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njetet e informimit.Formuletet për aplikim mund të merrën në Zyren e personelit të KK Dragashit-zyrja nr. 9,dhe dorzohen ne zyren e pranimit . Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Sherbimi i Personelit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

ANULIM I KONKURSIT

Anulohet konkursi për pozitën, **Zyrtar/e i/e Prokurimit, Pa Afat (I KARRIERES)**, me numër të referencës RN00003978, i shpallur më 07.11.2018, si dhe konkursi për pozitën, **Zyrtar/e i/e Prokurimit Me Afat (JO I KARRIERES)**, me numër të referencës RN00003979, i shpallur më 07.11.2018, arsya e anulimit është mos perfshirja e të gjitha kritereve te kualifikimi shkollore, për pozitën e larte cekur.

Nga aplikuesit për këte pozite kërkojmë mirëkuptim.

ANULIRANJE KONKURSA

Anulira se konkurs za položaj **Službenik/ca za javne nabavke, NEOGRANIČENO**, br. reference RN00003978, objavljen 07.11.2018, i konkurs za položaj **Službenik/ca za javne nabavke, OGRANIČENO**, br. reference RN00003979, objavljen 07.11.2018razlog za poništenje ne uključuju sve kriterijume za školsku kvalifikaciju, za gore nevedenim konkursom

Molimo prijavljene kandidate za razumijevanje!



Republika e Kosoves
Republika Kosova –Republic of Kosovo
Komuna Dragash- Opština Dragaš-Dragas Municipality

Na osnovu člana 11.12, stav 1 tačka 1.1 Zakona br. 03 / L-149 o državnoj službi Kosova, članovi 3 i 4 Uredbe br. 02/2010 o postupcima zapošljavanja u državnoj službi, Dragaš najavljuje ovo:

K O N K U R S

Br.03.111/01-27550
Naziv radnog mesta: Inspektor Veterine
Odsek: Inspekcijaska sluzba
Departament: Direktorijati za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj, turizam i inspekciju
Nivo plate, Koeficient: 7 (Grada 8)
Ugovor: 1 (jedna) godina (Sa mogucnosti produzetka)
Radno vreme: Puno radno vreme (40 sati nedeljno)
Izveštava: šefu inspekcije službe i direktoru
Svrha radnog mesta: promovisanje, praćenje, inspekcija veterinarskog kontrolnog sistema, na osnovu važećih zakona.

Dužnosti i odgovornosti;

- Vršiti inspekciju mesa i unutrašnjih organa životinja namenjenih javnoj potrošnji;
- Daje oznaku mesa, potvrđujući da je provereno i sertifikovano i da odgovara normama predviđenim zakonom za sigurnu javnu potrošnju;
- Kontrolise i prati uslove proizvodnje i prerade u vezi sa sigurnošću hrane životinjskog porekla za javnu potrošnju;
- Kontrolise klanice, fabrike za preradu mesa, mlekarë i kontrolu životinjske prehrane;
- Kontrolira sirovine i aditive koji se koriste u proizvodnji i pripremi hrane, kontroli sadržaja hrane;
- Uzimanje uzoraka u slučaju sumnje i slanje u laboratoriju;
- Nadgledanje privatnih veterinarskih praksi i veterinarskih tehničara u cilju preduzimanja mera za iskorenjivanje zaraznih bolesti;
- Sprečavanje i preduzimanje mera za borbu protiv zaraznih bolesti životinja;
- Kontrolise bezbednost hrane životinjskog porekla, kontroliše cirkulaciju otpada životinjskog porekla;
- Vršiti prijave za kršenje odredbi koje predstavljaju prekršaj;

Kvalifikacija Radno iskustvo i Potrebne veštine

- Univerzitetski stepen, veterinarska uputstva 3 godine profesionalnog iskustva.
- Znanje i iskustvo u oblasti veterinarske inspekcije;
- Veštine u planiranju komunikacije i timskom radu;
- Istraživačke, analitičke sposobnosti, procena i formulacija preporuka i saveta;
- Sposobnost obavljanja dužnosti i poslova pod pritiskom;

Računarske veštine softver aplikacija (Word, Excel, Pover Point, Internet); Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u informimit.Formulari za apliciranje se mogu dobiti u kancelariji Kadrovske sluzbe, SO Dragaš kancelarija br. 9, i predaju se prijemnoj kancelariji. Dostavljene aplikacije nakon isteka roka I nepotpuna dokumentacija, se neće razmatrati.

Kadrovska Sluzba

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “BTP Holding” Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:


DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për riciklimin e vajrave, yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturine në Banjë komuna e Vushtrrisë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.12. 2018. në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Bajska” në rrugën magjistrale Vushtri-Mitrovicë, do të organizohet debat publik nga kompania “BTP Holding” Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për riciklimin e vajrave, yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturine në Banjë komuna e Vushtrrisë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

